

**REDAKSIA:**

**KRYEREDAKTOR**

Syrja Xhelaj

**REDAKTORË**

Nuri Çuni  
Kujtim Boriçi

**KORRESPONDENTËT**

Ali Spahiu - Zvicër  
Përparim Kapllani - Kanada  
Eliton Pashaj - SHBA  
Agim Cani - Gjermani  
Enea Muhameti - Itali

**KONSULENTË**

Arian Leka  
Zenel Anxhaku  
Blerina Harizaj  
Agim Zeka  
Xhevdet Shehu

**DESIGN**

Studiograf "A&N"

**SHTYPET NË  
SHTYPSHKRONJËN**

"Urtësia  
Bektashiane"

Qershor, 2020



# Dashuri e vëllazëri për të gjithë



*B*usti madhështor i Fetah Backës, sigurisht, *Bi* ka munguar shumë këtij peizazhi, siç u ka munguar gjatë edhe shpirtit të besimtarëve tanë.





# Mirësi e përcjellë në breza

"Në ditë të këta, mos na ngjaj" - kënaqje e madhe për të gjithë ata që kanë qenë të mirë dhe të drejtë në jetë. Mirësi e përcjellë në breza është një vlerë e vyer që duhet të ruhet dhe të përhapet në të gjithë shoqëritë.

Niveli i mirësisë në shoqëri është një tregues i rëndësishëm i kulturës dhe vlerave të një kombi. Kur mirësi bëhet një traditë, ajo ndihmon në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të drejtë.



# Mirësi e përcjellë në breza

**“Në e do Alinë, mos më nga në plagë”, është një varg që mbyll shpesh herë mendimet e shenjtorit, Ballëm Sulltanit, i cili në mitet dhe folkun bektashian udhëton pa reshtur nga Azia e Largët, në Rumeli e deri në viset tanë...**

Faqe 8-9

# ETYD NGA MELÇANI

Kërkimi i etymologjisë së fjalës "Melçani" çel në kërkime të ndryshme të gjuhëtarëve. Në ditët e sotme, kjo fjalë përdoret shpesh për të përshkruar një shtet ose një grup të veçantë.

Një etymologji e mundshme lidh fjalën me fjalën "Mel" dhe "Çani", që do të thotë "shtet i melit". Kjo hipotezë është e diskutueshme dhe kërkon më shumë kërkime.



# Etyd nga Melçani


**E**kisha menduar ndryshe këtë ditë, më thotë **Ebaba Sadik Ibro. Jemi ulur mbi shkallaren aty pranë 'odës së kolonjarëve'. E çuditshme se si ka mbetur ky emërtim, që nga koha kur në krye të teqesë ishte baba Hysen Melçani.**

Faqe 12-13

# Mekam i dashurisë

Mekam i dashurisë është një vend i shenjtë që ka qenë qendër e adhurimit për shumë shekuj. Kjo vendndodhet në një zonë të bukur dhe të paqesme, ku besimtarët shpesh vijnë për të shprehur besimin e tyre.

Historia e Mekamit të dashurisë është e gjatë dhe e pasigurt. Një nga hipotezat është se ky vend ka qenë i njohur që nga kohët e lashta si një vend i shenjtë për adhurim.



# Mekam i dashurisë


**J**ubileu i teljes së teqesë bektashiane të Bubësit, **J**ka mbledhur këtë 15 qershor qindra besimtarë, këtu në kodrat e mrekullueshme të Zaimajt, përballë tyrbes së famshme të Abaz Aliut, në Tomorritin e përgjumur. ...

Faqe 14-15

# PËRSIATJE MBI TOMOR

Përsiatja mbi Tomorin është një refleksion i rëndësishëm mbi historinë dhe kulturën e kësaj zone. Kjo refleksion ndihmon në ndërtimin e një identiteti më të fortë dhe më të drejtë.

Tomorin është një vend i shenjtë që ka qenë qendër e adhurimit për shumë shekuj. Kjo vendndodhet në një zonë të bukur dhe të paqesme, ku besimtarët shpesh vijnë për të shprehur besimin e tyre.



# PËRSIATJE MBI TOMOR

**M**e Naim Frashërin kam përjetuar një kundërshti të pabesueshme: çdo largësi në hapësirë më është bërë afërsi e vetishme, çdo kuptim i jashtëm më është bërë kuptim i brendshëm. çdo harresë e mundshme më është bërë kujtesë

Faqe 16-17



# Rikthim në dritë i baba Fetahut

**B**usti madhështor i Fetah Backës, sigurisht, i ka munguar shumë këtij peizazhi, siç u ka munguar gjatë edhe shpirtit të besimtarëve tanë. Tanimë, ai ka zënë vend në oborrin e teqesë, në atë livadh të gjelbër, përzier me frymëmarrjen e pyjeve dhe të maleve shekullorë. Backa e ka pritur për dekada të tëra këtë çast. Jo se e pari harruar emrin dhe kujtimin e këtij babai të hershëm të teqesë, asnjëherë. Madje dhe kur u rrënuan teqetë nga themelet, besimtarët e kësaj treve pëshpërisnin nën zë: “Ja Allah, ja baba Fetah!”. Por sepse në esencë të filozofisë së tarikatit bektashian është kurdoherë një lloj rituali i përjetshëm midis myrvidit dhe myrshidit. Me bustin e sapo ngritur, ky ritual bëhet më i prekshëm, gati i sendërtueshëm në kohrat që kalojmë. Koncepti i hyjnore në tarikatit tonë, shkon mes qenies dhe bujarisë, gjer në zhveshjen prej ekzistencës vetjake. Rikthimi i baba Fetahut në shtëpinë e vet të dikurshme, do t’u shtrojë dritën dhe shpresën brezave të sotëm të besimtarëve, si një mirësi e Zotit ndaj baballarëve dhe gjysh-stërgjyshërve të tyre. Baba Fetah Backa ka qenë mik për kokë me Abdyl bej Frashërin dhe baba Alush Frashërin. Kaq mjafton, të përfytyrosh përpjekjet e tij kulmore në vitet më të rëndësishëm të zgjimit të kombit. Çështja kombëtare ka qenë një mision i vyer i i misionit fetar të klerikëve bektashian. Duhet ende shumë punë, duhen vite kërkimesh, së paku të formosh një ide të saktë rreth merakut të baballarëve tanë për Shqipërinë, jo vetëm







si një porosi unike e Haxhi Bektash Veliut për vatanin, por edhe si një përpjekje sifiziane për mos t'i ndarë Zotin dhe atdheun. Por ajo që më ka tërhequr instinktivisht, rreth figurës së baba Fetahut, është përcaktimi i veçantë

këtë klerik se: "Pajton meritë nëpër fshatra dhe kur nuk ka më në këtë zonë, as vrasje dhe as vjedhje." Kjo i bënte klerikët bektashinj të ishin njëherazi mistikë në bëma dhe po aq tokësorë në veprime.

## Baba Fetah Xhelaj (Backa)

Fetah Abdurrahman Xhelaj, lindi në vitin 1819, në katundin Kolonjë të Kurveleshit në Gjirokastër. Ai ndërroi jetë rreth vitit 1902. Nëna Gastare, nga fisi Mele, lindi Fetahun dhe katër vajza. Abdurahmani, babai, merrej me bujqësi dhe blegtori. Nuk vazhdoi gjatë, ai vdiq para kohe duke lënë të ve gruan dhe jetim djalin katër vjeçar dhe vajzat, në një moshë të vogël. Sidoqoftë Fetahu mbaroi medresenë me rezultate të mira në Gjirokastër. Më vonë vazhdoi shkollën fetare në Turqi, ku përveç shkollimit u njoh edhe me veprat madhore të mistikës bektashiane. Vizitoi vendet e shenjta: në Stamboll, Ankara, qëndrën botërore bektashiane, Haxhi Bektash e shumë vende të tjera, brenda dhe jashtë Turqisë. Fetahu pati një zell të madh për të njohur besimin bektashian, literaturën dhe tek ai u shfaq dëshira e adhurimit për këtë besim. Kjo erdhi natyrshëm, hap pas hapi duke u njohur dhe duke vepruar. Hyri në thellësi të kulturës dhe misticizmit bektashian, u bë myhib dhe dervish. U kthye në Shqipëri në vitin 1861, mbas disa vizitave të teqeve në jug të vendit u vendos në teqenë e Melçanit të Korçës me porosi të vëllezërve Frashëri dhe atdhetarëve të tjerë shqiptarë, që ishte lidhur gjatë kohës së qëndrimit në Stamboll. Këtu u vesh baba dhe punoi në zonën e Korçës dhe Gor-Opar për besimin bektashian, gjuhën shqipe dhe çështjen tonë kombëtare. Më vonë u vendos në teqenë e Backës ku kish filluar ndërtimi i saj dhe e përfundoi më 1863. Nga ana arkitektonike u bë një mrekulli e vërtet dhe ruan edhe sot e kësaj dite art të veçantë. Në portën e saj në krahun e majtë gdhendi shqiponjën dykrenare dhe simbolet e tjera fetare, unikal të teqeve në Shqipëri. Me ushtrimin e shërbimit fetar bektashian, lidhjet e ngushta me banorët e zonës me fjalën e urtë të Zotit, e besimin ndaj tij, me veprën atdhetare dhe arsime dashëse, shpejt tërhoqi vëmendjen dhe u bë i njohur në popullsinë e zonave të

Potomit, Korçës, Kolonjës, Skraparit e Përmetit. Ndodhej në çdo hall e shqetësim, ndihmonte të varfërit, pajtonte njerzit në grindje dhe mëri, edukonte me fjalën e ngrohtë, përcillte dashuri për atdheun. Arriti një autoritet të tillë të njerzisë, sa që banorët vendas e kthyen në një mit, duke u betuar: "Allahu dhe baba Fetahu". Mbahti lidhje të ngushta me teqetë e dëgjua të Melçanit, Qesarakës, të Frashërit e të Prishtës. Ishte miku i ngusht i baba Alushit, ku takimet me patriotët e rilindjes kombëtare i bënte në dervishijen e Gostomickës. Veprimtar në kuadrin e Lidhjes shqiptare të Prizrenit duke marrë pjesë aktive në degët e saj për Shqipërinë e Jugut dhe në mbledhjen e organizua nga baba Alushi dhe Abdyl Frashëri në teqenë e Frashërit në vitin 1878 së bashku me baba Meleq Staraveckën. Teqeja e Backës u bë qëndra e çetave atdhetare të Lace Backës, Çerçiz Topullit, Mihal Gramenos, Sali Butkës, Qamil Panaritit, Shahin Matrakut. Ishte veprimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit së bashku me baba Alushin, baba Meleq Shëmbërdhenjin dhe të patriotëve të tjerë skraparas. Në teqenë e Backës u organizua edhe një kuvend në vitin 1893, me një pjesëmarrje të gjerë, ku në mes të tjerash u vendos për hapjen e shkollave shqipe. Baba Fetahu hapi në teqe një kurs në gjuhën shqipe me 70 vetë dhe në vitin 1900, hapi në Backë shkollën e parë shqipe. Ushtrimin e besimit bektashianë e lidhi ngushtësisht me çështjen atdhetare shqiptare. Motoja e tij ishte: "Pa atdhe nuk ka fe". Bashkëpunoi me Petro Nini Luarasin, atdhetarë të tjerë, të cilët e furnizonin me libra shqipe. Baba Fetahu dergoi në teqenë e Qesarakës tre dervish për t'i përgatitur si mësues nën drejtimin e Petro Nini Luarasi, të cilët ishin nga Skrapari: dervish Meleq Muçoo (Staravecka, Shëmbërdhenji), dervish Tefik Hasa (Kapinova), dervish Rexhep Qafa (Veizi). Ky klerik është dekoruar me urdhrin "Për veprimtari patriotike" dhe titullin "Naim Frashëri" në maj 2018.

i studiueses së njohur britanike Hasluk, e cila pat shkruar rreth viteve 30-të të shekullit që lamë pas, pikërisht për

Ndonëse në ditë të vështira pandemie, ndonëse në ditë të ngarkuara me punë bujqësie dhe blegtorie,



bektashinjtë e Skraparit i ka zbritur së largu kujtimi i baba Fetahut. Madje, dashamirësit e kësaj teqeje, nuk kanë munguar as nga Vlora, as nga Mallakastra e Gjirokastra.

**Lulëzimi i teqesë së Backës, përkon me vitet heroikë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me kushtrimin për t’iu dalë zot fateve të kombit dhe krijimin e çetave të para të lirisë. E sendërtuar qysh në hapat e parë të saj, prej atdhetarit dhe fetarit të shquar baba Fetah Xhelaj nga fshati Kolonjë i Gjirokastrës, teqeja e Backës mbledhi rreth vetes atdhetarë me zë të Skraparit, të vetëdijshëm për misionin që do të mbanin në supe. Baba Fetahu, me erudicionin e thellë për tarikatën bektashi, rriti dimensionin shpirtëror të këtij objekti kulturi, me ç’rast, myhibët e tij vinin deri nga Kolonja e Përmeti. Dalëngadalë teqeja e Backës, u rrit dhe u shndërrua në një prej objekteve bektashiane të mahnitshëm, jo thjeshtë për atë kohë, por edhe për morinë e qindra teqeve të perandorisë otomane. Në mënyrë të veçantë, shqijonja dykrerëshe monumentale, e gdhendur në gurë në portën hyrëse të teqesë, shqijonja e flamurit të Skënderbeut, tregonte se bektashizmi shqiptar ruante dhe trashëgonte parimet më të larta të Muhamed Aliut, të rrugës së Hakut, përmes dashurisë së përjetshme për atdheun. Mësimi dhe këndimi në gjuhën shqipe, pritja dhe përcjellja e luftëtarëve të lirisë, e formacioneve të shumtë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, por edhe jeta fetare aq e dliër, është historia e kësaj teqeje.**

Nuk mund ta linin vetëm, veçanërisht sot, birin e tyre, bektashinjtë e fshatit Kolonjë të Gjirokastrës, të cilët ndajnë prej vitesh këto ditë feste me vëllezërit skraparllinj, duke dëshmuar atë, të mrekullueshmen vëllazërinë shpirtërore të tarikatit. Nebiu më tregon se në fillim, kishin menduar për ceremonial sa më të thjeshtë, se e tillë është koha, plot andralla. Por besimtarëve, s’ke ç’u bën, thotë ai, tani ka dal celulari dhe mbrëmë vonë, duke bërë llogari, na dilnin më shumë se 300 vetë. I mbledhi kujtimi i atij burri të madh, atij mësuesi të filozofisë së Haxhi Bektashit dhe gjuhës së bukur shqipe.

Kanë ardhur të ndajnë bashkë gëzimin e kësaj dite qershori edhe djemtë e Vlorës labe, bilbilat e këngës polifonike, por edhe të nefeseve bektashiane të grupit “Fladi i Ehli-Bejtit”. Zërat e tyre kanë mrekulluar për katër vite rresht, “La Palais” në Paris, në ditët e kulturës

bektashiane, duke fituar zemrat jo vetëm të shqiptarëve. Sipas një tradite që sa vjen dhe pushton hapësirën e kulturës bektashiane, tanimë çdo teqeje, çdo babai apo dervishi të shquar u këndohet kënga. Sot është radha e respektit të thellë ndaj veprës së baba Fetah Backës. Si një dhuratë e bukur e vlonjateve për këtë klerik, zërat e Robert Memajt, Irfan Bocajt, Sokol Hodajt, Viron Lacajt dhe Engjëll Tahirajt, bashkohen me ato të zogjve, në rrapin e lartë: O baba, o mal i rëndë/ Erdhe zure vendin tënd/.

Paskëtaj, sekretari i gjyshit të Skraparit, Zalo Qato, ka falënderuar të pranishmit, duke iu kujtuar të gjithëve se vepra e baba Fetah Backës, do të jetojë gjatë në memorien e skraparllinjve. Ndërsa Kryetari i Bashkisë së Skraparit, z. Adriatik Mema, u shpreh mes të tjerave se ditë të tilla përbëjnë vete jo vetëm për bektashinjtë, po për gjithë popullin, sepse edhe vepra e baballarëve e tillë ka qenë, kurdoherë në të mirë të kombit. Ai ishte ndërkaq i bindur se klerikët e sotëm bektashinj po ecin në gjurmët e paraardhësve të tyre, aq të nderuar.

Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, tha:

“...Dita e bekuar e çeljes së kësaj teqeje, vite më parë, na çon në vitet e vetëdijes sonë nacionale, në ato vite kur baballarët e kombit po kuptonin se tirania pesë shekullore duhej flakur një orë e më parë, për





*...Ali Koroveshi është nga fshati Lofkënd i Mallakastrës.. Ai rrëfen se si i lindi ideja të sponsorizonte bustin e baba Fetahut: "Jam rritur me rrëfimet e prindërve dhe gjyshërve të mijë për teqetë dhe baballarët. Kam shkuar qysh në vitin 1994 në Angli si emigrant dhe kam punuar sa unë vetë e di. Emrin e baba Fetahut e dëgjoja në emigracion prej skraparlinjve dhe gjirokastriteve. Deri aty ka ardhur fama e këtij shenjtori. Por kur para disa kohëve erdha këtu në Backë, u mahnita. Kjo nuk është teqe. Kjo këtu, është një vepër arti e mrekullueshme. Shkova në Tiranë dhe takova skulptorin, Dylber Neziri. Folëm gjatë. Donim që komplek-sit bektashian të teqesë t'i shtonim një tjetër vepër arti, që*

*kujtimi i këtij kleriku të vinte sa më i gjallë. E falënderoj me shpirt, Dylberin. U ndjeva mirë sot, jo thjeshtë se kam paguar disa lekë, por se si mallakastriot, do të mbetem familjarisht në rrethin e miqve dhe dashamirësve të kësaj teqeje me kaq histori"*

ta renditur Shqipërinë tonë në familjen e madhe evropiane, në gjenezën tonë natyrore. Këta burra të Shqipërisë u mbështetën plotësisht tek dervishët dhe baballarët bektashianë, të cilët jo thjeshtë me fjalë, por me vepra dhe sakrificat patën dëshmuar se doktrina dhe filozofia e Haxhi Bektash Veliut, në qendër të tyre, kanë lirinë individuale dhe kombëtare. Lulëzimi i teqesë së Backës, përkon me vitet heroikë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me kushtrimin për t'iu dalë zot fateve të

kombit dhe krijimin e çetave të para të lirisë. E sendërtuar qysh në hapat e parë të saj, prej atdhetarit dhe fetarit të shquar baba Fetah Xhelaj nga fshati Kolonjë i Gjirokastrës, teqeja e Backës mblodhi rreth vetes atdhetarë me zë të Skraparit, të vetëdijshëm për misionin që do të mbanin në supe. Baba Fetahu, me erudicionin e thellë për tarikatin bektashi, rriti dimensionin shpirtëror të këtij objekti kulti, me ç'rast, myhibët e tij vinin deri nga Kolonja e Përmeti. Dalëngadalë teqeja

e Backës , u rrit dhe u shndërrua në një prej objekteve bektashianë të mahnitshëm, jo thjeshtë për atë kohë, por edhe për morinë e qindra teqeve të perandorisë otomane. Në mënyrë të veçantë, shqiptarja dykrerëshe monumentale, e gdhendur në gurë në portën hyrëse të teqesë, shqiptarja e flamurit të Skënderbeut, tregonte se bektashizmi shqiptar ruante dhe trashëgonte parimet më të larta të Muhamed Aliut, të rrugës së Hakut, përmes dashurisë së përjetshme për atdheun. Mësimi dhe këndimi në gjuhën shqipe, pritja dhe përcjellja e luftëtarëve të lirisë, e formacioneve të shumtë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, por edhe jeta fetare aq e dliirë, është historia e kësaj teqeje. Vargu i gjatë i dervishëve dhe baballarëve që shërbyen në këtë vend, zënë vend padyshim në panteonin e bektashizmit shqiptar dhe, brezat e sotëm i përcjellin ata me respektin më të thellë. Ne të gjithë, vlen të punojmë pa u lodhur që të hulumtojmë jo vetëm nëpër dosje arkivash, por edhe në memorien e kësaj treve, për të hedhur dritë sa më shumë mbi jetët e tyre plot sakrificat. Ne duhet ta dëshmojmë këtë histori, jo thjeshtë në aspektin fetar, por edhe atë kombëtar, sepse të tilla kanë qenë realitetet nëpër të cilat kaluan klerikët bektashinj...". Motra dhe vëllezër! Kam kënaqësinë e veçantë të falënderoj sot përpara jush mikun tonë Ali Koroveshi, për gjestin e tij bujar, çfarë mundësoi rikthimin e baba Fetahut në këtë vepër madhështore arti. Gjithashtu një falënderim i veçantë shkon sot për këshillin e Gjyshitës së Skraparit dhe në veçanti për z.Zalo Qato, i cili energjik si gjithmonë ka mundur të ringrejë nga harrimi objekte kulti kaq të veçanta siç është dhe kjo teqe. Zbulimi i bustit të baba Fetahut, është përcjellë me duartrokitje dhe urime. Nuk kanë munguar fotografitë që besimtarët e shumtë kanë bërë me baba Fetahun. Pastaj lëndina në prag të teqesë, ka mbetur 'peng' e valleve dhe nefeseve bektashiane.

Syrja XHELAJ  
Fotot: Mehdi Nako




# Mirësi e përc

“Në e do Alinë, mos më nga në plagë”, është një varg që mbyll shpesh herë mendimet e shenjtorit, Ballëm Sulltanit, i cili në mitet dhe folkun bektashian udhëton pa reshtur nga Azia e Largët, në Rumeli e deri në viset tanë shqiptarë, kurdoherë në prani të dyzet dervishëve bektashinj. Dyzet dervishët e tij, mund të jenë një metaforë, po aq sa dhe një realitet, nëse mendojmë se përgjatë zhvillimit të tarikatis, ishin pikërisht këta dervishë të cilët sakrifkuan jetët e tyre, duke mbajtur në shpatulla një peshë të rëndë. Atë të përhapjes së dritës së Imam Aliut, paqja qoftë mbi ‘Të, por edhe të shpresës për jetën, të vlerësimit të adhurimit, për gjërat e përtejshme të kësaj bote. Rasti i Ballëm Sulltanit, i kudondodhur me dervishët e tij, është pa më të voglin dyshim, një sintetizim i afërsisë shpirtërore të klerikëve të tarikatis tonë.

Duke kumtuar rreth dashurisë për Imam Aliun, brenda veprimtarisë së Ballëm Sulltanit, baba Rexheb Beqiri nuk harron të theksojë se myrshidi, jo vetëm që duhet ta dojë dhe respektojë Imam Aliun, por duhet ndërkaq edhe të veprojë ashtu siç urdhëron Imami ynë, sepse pastaj, nuk ka kuptim dashuria. Dashuria shpirtërore, pa veprimtarin e urdhëruar nga Aliu a. s, mbetet si diçka e thatë, e pavlefshme. Dhe ky është pikërisht meraku i Ballëm Sulltanit kur përsërit se “në e do Alinë, mos më nga në plagë”. Sentenca buron sigurisht prej parimeve më të vyera bektashianë, të ngjizura në filozofinë dhe tejpamësinë e Pirit tonë, Haxhi Bektash Veliut.

Këtë urtësi e mirësi përcjellin ndër breza, klerikët e sotëm, të cilët duke treguar mjaft kujdes për vetë kushtet e pandemisë që po kalojmë, janë gjithsesi të kujdesshëm që besimtarët t’i kenë sa më pranë syve. Baba Hysni Shehu, në krejt këto kohëra, ka





# Shpellë në breza

komunikuar në pjesën më të madhe me telefon, duke marrë pjesë në çdo gëzim apo shqetësim në vatrat e martaneshasve dhe duke falur kurdoherë durim dhe paqe. Se kohërat janë vërtetë të vështira, por në fund të fundit edhe misioni i klerikëve bektashianë i tillë ka qenë, i vështirë, i mbushur me sakrifica fizike dhe shpirtërore, i nxitur prej qëllimeve më të bukura në devocionin ndaj Krijuesit. Prandaj edhe në 29 qershorin e sivjetshëm, vendi i bekuar, Ballenja, është mbushur plot besimtarë dhe plot shpresa për ditë më të mira. Komunikimi i ngrohtë, thujse vëllazëror i pelegrinëve të ardhur jo vetëm nga Martaneshi, por edhe Dibra e Kruja, përbën në vetvete, një bashkim shpresash për udhën e gjatë të jetës.

Skënder Gjoni, me atë thjeshtësinë bektashianë, me merakun që veprimtaria e këtij viti, ndonëse në kushte tepër të vështira, të sjellë sa më shumë paqe, është kujdesur për çdo detaj të festës. Ata kanë pritur pelegrinët grupe-grupe në teqe, pastaj i kanë shoqëruar në lëndinat e mrekullueshme, madje natën, pranë zjarreve, pranë bisedave dhe këngëve, janë gjendur pranë edhe ndonjë shqetësimi të vogël. Edhe pse pelegrinët nuk u mblodhën me qindra, si vite më parë, ata shijuan paqen që të fal vendi i mirë u lutën për ditë më të bukura, shkëmbyen urime e këngë nga grupi në grup. Ndërsa Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, gjithashtu nuk ngurroi të shkonte nga njeri grup tek tjetri, duke i falënderuar këta besimtarë që me devocionin e tyre sfidojnë kohërat.

Pranë vendit të mirë, në shoqërinë e atyre që kanë ndezur qirin dhe janë lutur, Kryegjyshi thotë: "...

Kjo mrekulli që Zoti ka bërë në këtë vend, sigurisht që ka qenë vullneti i Tij. Por që kjo mrekulli të ruhej e bukur dhe e paprekur në shekuj, është pikërisht teqeja bektashianë, vendi i mirë me emrin e Ballëm Sulltanit, janë brezat e gjatë të klerikëve dhe besimtarëve të Haxhi Bektash Veliut, të cilët me frymën dhe përpjekjet e tyre e pasuruan më tej këtë vend të bekuar. Përgjatë shekujve, bukuritë natyrore të këtyre maleve dhe lëndinave, u janë bashkuar bukuritë njerëzore dhe ato hyjnore. Duke u ngjitur për në vendin e mirë të Ballëm Sulltanit, ne sigurisht sjellim ndër mend krejt ato teqe e vende të shenjtë bektashianë, të cilët i falën këtij shenjtori përfytyrimin e saktë të tarikatit, duke e bërë që të ngrihet mbi mistikën sipërfaqësore të kohës. Duke parandjerë rëndësinë e tarikatit bektashian, në rrafsh të zhvillimeve fetare dhe njerëzore të më vonshme, sidomos në trevën e Ballkanit, Ballëm Sulltani vuri në baza të shëndosha sidomos moralin dhe etikën e ndjekësve të Imam Aliut, duke kërkuar tek çdo dervish apo baba, në radhë të parë, njeriun e urtë dhe të ditur që u përket



Foto: Ardian Koxherri





traditave më të mira të besimit. Më lejoni t'ju sjellë sot këtu, katër vargje lapidare, të këtij shenjtori, i cili na drejtohet të gjithëve ne, pavarësisht brezave dhe kohërave:

*Gjithë besimtarëve kur janë të bashkuar,  
Dorën e Hynqarit kur kanë shtrënguar,  
Nga punët e liga ata janë larguar,  
Po në do Alinë, mos më nga në plagë!*

Dhe besoj se të gjithë e dimë që, në konceptin bektashian të bashkimit, jemi një, të gjithë, të shkrirë në devocionin ndaj Krijuesit, të vëllazëruar në atë shkallë që të na gëzojë çdo mirësi në shtëpinë e vël-lait tonë, sikundër të na hidhërojë çdo hidhërim në shtëpinë e tij. Ne kemi qenë dhe do të mbetemi kur-dohërë në krye të punëve të mira, qofshim vëllezër barku apo vëllezër Haku.

Mesazhet që ka përcjellë këtyre anëve, jeta dhe vepra e Ballëm Sulltanit, kanë rezonuar në kohë dhe hapësirë.

Klerikët, por edhe myhibët dhe dashamirësit e te-qeve të Martaneshit, Bulqizës dhe Dibrës, mbështetën qysh në fillim lëvizjen kombëtare shqiptare, sipas parimit bektashian që vatani duhet mbrojtur me çdo kusht, si një detyrim ndaj Zotit. Burime të shumtë të historiografikë sonë, kanë vërtetuar katërcipër-isht se në çdo lëvizje madhore të këtyre trevave, sa në përhapjen e gjuhës shqipe, aq edhe në organizimin e çetave të luftëtarëve të lirisë, roli i klerikëve bektashianë ka qenë i padiskutueshëm.

Ky rol, sot e kësaj dite, bashkudhëton me fatet e Shqipërisë, duke dëshmuar jo thjeshtë dashurinë për kombin, por edhe sakrificat e panumërta për të mbajtur gjallë frymën tonë kombëtare.

Këtij roli të klerikëve tanë ndër vite, i është ngjitur padyshim edhe vëllai ynë dhe i juaji, baba Hynsi Shehu, i cili ndonëse në terrene të vështirë, ecën në gjurmët e klerikëve më të mirë të këtyre teqeve. Kam kënaqësi ta falënderoj sot për punën e bërë, si dhe përkushtimin ndaj tarikatit tonë.

Respekt të thella gjithashtu shpreh sot për këshillin e teqesë së Martaneshit, për myhibët dhe dashamirësit e saj, të cilët edhe në kohëra të vështira, ruajnë të gjalla traditat tona më të vyerat.”

**Koresp. “Urtësia”**

# Çaste të paha

**Nga Brunilda Gorovelli**

**U** futëm në vitin e tretë që çdo datë 18 Qer-shor zhvillojmë me një krenari të ligjshme pelegrinazh në tyrben bektashianë në Vendin e Mirë, në Karbunarë të Vogël të Lushnjës. Ndonëse në situatë të vështirë nga pandemia botërore, por me besim e lutje drejtuar Zotit, nuk munguan besimtarët e kësaj zone, të cilët mezi presin që ta shohin të rindërtuar vendin e shenjtë. Gjelbërimi, qetësia dhe ajri i pastër me të cilin vendi është rrethuar, tërheq drejt vetes besimtarët Lushnjarë dhe jo vetëm. Duket se për çdo tyrbe, peligrinazhi është një bekim, sepse shtëpia e Zotit mbushet plot me besimtarë. Fëmijë të vegjël, të rritur, të moshuar, besimtarë të ardhur edhe nga fshatrat përreth kërkonin bekimin nga Zoti, e përherë e rrethojnë plot kërshëri dhe dashuri dervish Saliun për të marrë uratë.

Nuk mund të mungonet adeti i bërjes së Kurbanit dhe lutjes nga ana e dervishit për shëndet, mirësi dhe begatin e të gjithë besimtarëve që ndodheshin aty. Edhe vetë banorët e fshatit në këtë ditë të veçantë kërkonin dhe bënin lutje për zgjidhjen e problemeve. Duke u lutur në tyrbe, ata ndjehen të qetë dhe të lumtur, duke besuar që problemet e tyre do të zgjidhen. Banorët e kësaj zone tregojnë se zona ku ndodhet tyrbja e Karbunarës së Sipërme (të Vogël), më herët ka qenë një varrez dhe pranë saj, Vendi i Mirë, ndërkohë që gjatë sistemit komunist u kthye në një zonë të banueshme. Të pranishëm në këtë peligrinazh ishin edhe përfaqësues të Kryegjyshit Botërore Bektashian në Tiranë, dervish Sali Peti dhe sekretari Nuri Çuni, të cilët përherë janë treguar të gatshëm duke ardhur çdo vit në këtë vend të shenjtë. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Selisë së Shenjtë, bën që shumë prej besimtarëve të mësojnë më shumë për tarikatin bektashian. Dervish Saliu na rrëfen për “sekretet” e shumtë të baballarëve bektashian dhe mbi të gjitha për dashurinë e tyre të përjetshme për dijen. Ai më pas u përcollti mesazhin e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj se: “Sot vijmë këtu në Karbunarën e Vogël-Lushnjë, dhe hapim këtë ceremoni modeste të Vendit të Mirë. Ky vend ka një histori të hershme të misionarve të ardhur edhe këtu në Karbunarën e Vogël. Në krye të herës në këtë vend ka qenë një varrezë e madhe, xhami dhe një tyrbe e vogël, pranë burimit të Hakajve. Kjo lidhet me burimet historike dhe të dhënat e pleqve të vjetër se në Lushnjë ka patur kisha, xhami,



# Arruara në ditë të vështira



tyrbe dhe teqe. Fakti i një teqe në Çiflik-Çermë dhe në vitin 1870 është themeluar teqeja e baba Skënderit, që sot kemi tyrben e tij brenda qytetit është domethënës për rrezatimin dhe mesazhet që ka dhënë baba Skënderi mbi besimin bektashian, jo vetë qendër të Lushnjës por edhe më gjërë. Po kështu në një hartë italiane të vitit 1939 jepet shenja e tyrbes në Karbunarën e Vogël pranë varrezës, të cilat janë prishur përfundimisht pas çlirimit kur u krijua kooperativa bujqësore.

Jepen edhe të dhëna gojore se ka ardhur edhe një dervish nga qyteti i Krujës e ka qëndruar një periudhë kohe. Ceremonitë fetare të Sulltan Novruzit, mbajtja e matemit dhe dita e Hashures, Barjamit Madh dhe Kurban Barjamit, kanë mbetur të gjalla në memorijen e besimtarëve dhe dashamirësve të fshatit Karbunarë.

Sot në këtë ceremoni ne kujtojmë dhe ruajmë gjallë, gjurmët e mësimet e dervishit, të baba Skënderit dhe pasuesve të tij, që mbollën dashuri, mirësi, vëllazëri e harmoni në këtë vend të Mirë. Me këtë rast dua të falenderoj përkushtimin dhe dashurinë për besimin bektashian znj. Nadire Gorovelli me të afërmit e familjes dhe në ringritjen e tyrbes në përhapjen e frymës të vëllazërisë dhe shpresës.”

Besimtarët dhe dashamirësit urojnë njëri-tjetrit në këtë ditë të shënuar dhe me shpresë marin dashurinë

dhe mirësinë e këtij vendi të shenjtë. Për vizitorët vendas ose të huaj, do të ishte një shëtitje shumë e bukur në një zonë komplet fshat, por ndërkohë mund të ndalojnë dhe në disa pika shumë interesante historike. Përpos sodisjes së fshatit ndalesa në tyrbe është si qershia mbi tortë pasi shpirtërorja dhe toksorja takohen së bashku. Ajo ndodhet vetem 5 kilometra nga qyteti i Lushnjës ose 6 minuta me makinë. Karbunara e Vogël përbëhet nga disa fise si: Gorovelli, Shabani, Sinani, Haka, Xhumari, Senka etj. Tyrbja e Karbunarës së Vogël ndodhet midis lumit të quajtu Lunja, kodrës së Mollasit (dikur Murtaja) dhe përroit të vogël. Dikur një varrezë e cila u zhduk në kohën e periudhës komuniste duke u kthyer në vendbanim dhe një pjesë në tokë bujqësore. Aktualisht, në këtë zonë të varrezës janë vendosur banorët me mbiemrin Gorovelli, të cilët kanë zbritur aty nga kodra e Mollasit (Murtajes), e cila është pika më e lartë e qytetit të Lushnjës 299 m mbi nivelin e detit. Më herët ky mbiemër ka qëndruar në Tomoricë të Skraparit, gjë që shpjegon edhe lidhjen e fortë me bektashizmin. Megjithatë, ne duhet të themi se në qytetin e Lushnjës ka besimtarë bektashianë, por edhe një tjetër tyrbe siç është ajo e baba Skënderit. Të dy këto objekte kulti në zemër të Myzeqesë, shpërndajnë shpresa dhe na falin çaste të paharruar sidomos në këto ditë të vështira.



# ETYD NGA MELÇANI

**E**kisha menduar ndryshe këtë ditë, më thotë baba Sadik Ibro. Jemi ulur mbi shkallaren aty pranë ‘odës së kolonjarëve’. E çuditshme se si ka mbetur ky emërtim, që nga koha kur në krye të teqesë ishte baba Hysen Melçani. Por rrëfejnë se, aq shumë e donin besimtarët babanë, sa njëra prej dhomave të teqesë asnjëherë nuk mbeti pa mysafirë nga Kolonja. Tani baba Sadiku po e ringrej konakun,

duke dashur të ringrej edhe ato copëza historie që lidhen me ‘të. Veçanërisht bektashizmi shqiptar i detyrohet shumë kësaj teqeje. Tashmë jo vetëm nga historianët tanë, por edhe zbulime të reja të dokumenteve osmanë, kanë nxjerrë në dritë faktin e pamohueshëm se pikërisht në konakët e kësaj teqeje, u ngritën të parat çeta luftëtarësh kundër Portës së Lartë, duke ndezur paskëtaj flakët e një zjarri të madh, të çështjes

**Me besimtarë të ardhur nga të gjitha viset shqiptare, me këngë e valle. Sepse e meriton ajo teqe, e meritojnë dervishë dhe baballarë gojmjaltë që në tri shekuj e gjysmë pritën e përcollën në këtë shtëpi dashurie të Haxhi Bektash Veliut, breza të tërë besimtarësh, burra të shquar që nga Petro Nini Luarasi, tek Naum Veqilharxhi, nga Çerçiz Topulli tek Mihal Grameno, nga motrat Qiriazit tek Mit’had Frashëri. Për disa kohë, me ardhjen në Shqipëri të Qendrës Botërore Bektashiane, këtu ka qëndruar edhe vetë Sali Niazi Dedei.**



Foto: Mehdi Nako





tonë kombëtare. Unë e shtyj më tej bisedën me baba Sadikun dhe ai më thotë se donte ta festonte me madhështi ditën e 22 qershorit, jubileun e 350 vjetorit të teljes së teqesë. Me besimtarë të ardhur nga të gjitha viset shqiptare, me këngë e valle.

Sepse e meriton ajo teqe, e meritojnë dervishë dhe baballarë gojëmjaltë që në tri shekuj e gjysmë pritën e përcollën në këtë shtëpi dashurie të Haxhi Bektash Veliut, breza të tërë besimtarësh, burra të shquar që nga Petro Nini Luarasi, tek Naum Veqilharxhi, nga Çerçiz Topulli tek Mihal Grameno, nga motrat Qiriazit tek Mit'had Frashëri. Për disa kohë, me ardhjen në Shqipëri të Qendrës Botërore Bektashiane, këtu ka qëndruar edhe vetë Sali Niazi Dedei. Sytë e bektashinjve të gjithë botës, vështronin përmes dridhjeve të mallit, këtë vend të bekuar të Melçanit.

Por, në kushtet e kësaj pandemie

që po zgjatet, sigurisht ky jubileu i lavdishëm do të kalonte pa u ndjerë. Baba Sadiku më rrëfen se ishte i ndërgjegjshëm për këtë ditë pa festë. "Telefonatat ishin me qindra, thotë ai, por unë u thosha se nuk do të mbliidhemi. Festoni në shtëpitë tuaja, i uroja të gjithë. Me kismet në mot, me Zotin përpara, bëjmë diçka të bukur."

Më bën përshtypje një vajzë e ardhur nga Korça. Është studente në universitet dhe me zë të ulët i thotë baba Sadikut se "jam vonuar për të ardhur në teqe, se ka qenë sezon i vështirë dhe kam provime për të dhënë." S'ka gjë, i thotë babai. Shiko librat, jeta pa libra, pa dituri, është një shpërfillje nga porositë e Krijuesit, nga amaneti i baballarëve bektashianë. Teqenë këtu e ke, në mot, do ta bëjmë edhe më të bukur. Sa më shumë do ta lexosh, aq më shumë do ta duash detin pafund të urtësisë së tarikatit.

Bashkë me aromën e mrekullueshme të blirëve që po hedhin shtat, më vijnë përpara syve këshillat e Pirit tonë, Haxhi Bektash Veliut, kur përmes urtësisë proverbiale porosiste: "O dervish, dije se veliu i Allahut është Nuhu i kohës së vet."

Ndihma e tij është anija që i shpëton robërit prej të keqes dhe përmytjes. Në përmytjen e ujit, po të kesh trup të fuqishëm edhe mund të shpëtosh. Por përmytja prej padijes është më e rëndë, më e ligë. Sepse dikush që përmytjet në 'të, nuk shpëton dot deri në përjetësi.' Si rrallëkund në historinë e religjioneve fetare, pasuria diturore bektashiane, ka shërbyer brenda dijes së mrekullueshme njerëzore. Duke përcjellë tek brezat e besimtarëve idenë e lume se pa dashurinë ndaj dijes, nuk mund të ecësh gjatë në udhëtimin me shpirtin.

**Syrja Xhelaj**



# Mekam i dashurisë

**J**ubileu i teljes së teqesë bektashiane të Bubësit, ka mbledhur këtë 15 qershor qindra besimtarë, këtu në kodrat e mrekullueshme të Zaimajt, përballë tyrbes së famshme të Abaz Aliut, në Tomorrin e përgjumur. Shumica e tyre kanë ardhur në ndajnatën e 14 qershorit, kanë bërë lutjet e zakonshme pranë mezarit të baba Aliut. Nuk kanë munguar as lulet e freskëta të malit, sidomos nga fëmijët. Me kërshërinë e tyre të çuditshme, ata rrinë pranë prindërve dhe dëgjojnë lutjet nën zë, a thua se do të kapin fjalët e dala shpirti që u ngjiten paskëtaj maleve dhe qiejve. Jetojnë çaste që ndoshta do i kujtojnë gjithë jetën.

Filozofinë e lutjeve bektashiane, rreket të ma sqarojë nënë Esmaja e cila ka ardhur nga Kiçoku dhe më thotë: “Kam ardhur gjithnjë tek mezari i baba Aliut dhe në gëzime të mëdha, por edhe në dëshpërime të mëdha. Kur kisha gëzim, doja t’ja tregoja baba Aliut. Kur kisha dëshpërim, doja të ma hiqte. I qofsha falë, ai baba t’i hiqte me dorë dëshpërimet, sikur ato të peshonin edhe sa një mal. Para disa vitesh në fshat na erdhi lajmi se një mbesa ime në Greqi ishte shtruar në spital, shumë rëndë. Jallah mor djalë, qysh vrapuan të gjithë atje. Po unë plaka ndeza ca qirinj dhe e mbajta frymën këtu, tek baba Aliu.

U luta e u luta me zë. Ma dëgjuan lutjen baba Aliu dhe Zoti që është Një. Kocja u kthye shëndoshë e mirë në fshat. Këto mekame, po t’i duash një herë, të duan dhjetë herë”.

Një e vërtetë shumë e çiltër kjo, në marrëdhëniet hyjnore midis besimtarëve dhe mekameve. Por që t’i duash një herë këto mekame, duhet të udhëtosh për tek Haku, në mijëra e mijëra ditë-net, duke u shpëtuar kurtheve të kësaj bote.

Të ngjashme në aktin e tyre me sirenat e mitologjisë greke, gjërat e përkohshme dhe të vdekshme të kësaj bote, ngrenë prita pa mbarim dhe vetëm një zemër

e pastër, mund të përballet me ‘to, duke iu afruar plot drithërimë mekamt të dashurisë hyjnore. Duke medituar rreth këtij realiteti, sufiu i madh, Muhamed Ikbali, ka shkruar shekuj më parë: “Mekami i dashurisë nuk është tryezë, por druri i varjes. Ibrahimët e dliirë nuk frikësohen kurrë prej Nemrudëve. Njeriu jeton vetëm me shpirtin e tij të dorëzuar tek Zoti. Kini kujdes prej atyre që shpirtin e lenë në hipotekë dhe jetojnë vetëm me trupin.”

E përcjellë në ditët e sotme, kjo filozofi e sendërtuar në jetëgjatësinë e tarikatit bektashi, mbetet





domethënëse. Këta besimtarë që mbushin sot oborrin e teqesë së Bubësit, ndoshta mund të kenë njëqind halle dhe probleme ekonomike. Por i kanë lënë pas krahëve të gjitha, me gëzimin për t'u bashkuar në dashurinë dhe devocionin ndaj Krijuesit.

Vëllezërit Zaimaj së bashku me motrat dhe nënën e tyre, Sanijen, fëmijët dhe nipërit e tyre, mbajnë si relike të shtrenjtë një kronikë të këtij pelegrinazhi në vitin 2010. Asaj kohe, tek mezari i baba Aliut, u përkul vetë dede Reshat Bardhi, duke kujtuar se vepra e këtij kleriku i bën nder jo vetëm tarikatit bektashian në Shqipërinë e Jugut, por krejt bektashizmit.

Ai udhëtoi deri në Janinë për të marrë aty libra shqip dhe i shpërndau në Frashër dhe Alipostivan, në Prishtë dhe Gjirokastrë. Pas kësaj fjale të shkurtër, dede Reshat Bardhi, i rrethuar nga qindra pelegrinë, këndoi me atë zërin e tij të mrekullueshëm këngën emblemë të tragjedisë së Imam Hysenit, sipas fjalëve të kryepoetit Naim Frashëri:

*“O moj fushë e Qerbelasë,/*

*Që më rri në sy,/*  
*Plot me gjak të Ali-Abasë,/*  
*Vallë ç'është ai...”.*

Pastaj sheshi gjëmoi nga duartrokjet dhe nuk reshte, deri sa zëri i dedeit, mori qiejt. Genci, më thotë se të gjithë ne, e mbajmë në telefonat tanë atë këngë të kënduar me shpirt dhe e kemi të pranishme në çdo ditë e natë gëzimi. Ndërkohë që nuk harrojmë edhe vizitat e bisedat me Kryegjyshin e sotëm, baba Mondin, për

të cilin ruajmë respekt të veçantë.

Rrethi i gjerë i valles, aty nën hijen e mollëve dhe bajameve, duart e shtrënguara me njeritjetrin të të rinjve besimtarë, tingujt e këngëve për dervishët e baballarët bektashinj, i ngjajnë një afresku të bërë me penelat drite.

Askush në këto ditë, nuk mund ta mbushë shpirtin e një pelegrini halleshumë, se sa kjo valle dhe kujtimi i mrekullueshëm i baballarëve të teqesë. Sikundër edhe për klerikët tanë, të djeshëm dhe të sotëm, këta zëra pelegrinësh, këtu në lartësitë e maleve dhe qiejve, marrin një kumbim të veçantë.

Kjo marrëdhënie e përjetshme e myrshidit me myridët dhe dashamirësit e vet, ky bashkëbisedim midis atyre që janë në këtë botë dhe të tjerëve që e kanë lënë atë, është një ndërfaqet e pashkruara, por sigurisht më prekëse të filozofisë dhe madhështisë bektashiane.

**Syrja Xhelaj**

**Asaj kohe, tek mezari i baba Aliut, u përkul vetë dede Reshat Bardhi, duke kujtuar se vepra e këtij kleriku i bën nder jo vetëm tarikatit bektashian në Shqipërinë e Jugut, por krejt bektashizmit. Ai udhëtoi deri në Janinë për të marrë aty libra shqip dhe i shpërndau në Frashër dhe Alipostivan, në Prishtë dhe Gjirokastrë. Pas kësaj fjale të shkurtër, dede Reshat Bardhi, i rrethuar nga qindra pelegrinë, këndoi me atë zërin e tij të mrekullueshëm këngën emblemë të tragjedisë së Imam Hysenit, sipas fjalëve të kryepoetit Naim Frashëri:**





# PËRSIATJE MBI TOMOR

Naim  
Frashëri është  
njeriu i rrallë shqiptar,  
por edhe ballkanik, njeriu i  
njerëzimit brendapërbrenda  
protagonizmit të tij  
historik.



Me Naim Frashërin kam përjetuar një kundërshti të pabesueshme: çdo largësi në hapësirë më është bërë afërsi e vetishme, çdo kuptim i jashtëm më është

bërë kuptim i brendshëm. çdo harresë e mundshme më është bërë kujtesë e pashlyeshme. çdo mungesë më është bërë intimitet dhe çdo boshësi, zbrazje, humbje




më janë bërë përmbajtje, mbushje dhe fitim i pakufishëm. Poeti është i aftë të krijojë Trininë me Qiellin dhe Tokën. Njeriu nuk ndryshon nga ajo që ka qenë më parë. Ndryshon vetëm nga ajo që bën. Naim Frashëri në këtë pikë ka bërë më shumë nga ç'mund të mendohet. Ai është **“të bërët”**, d.m.th. kaosi, që bëhet krijimi i kozmosit. Ky cak zanafillor bëhet prag kapërcyes, e shkuara na shtyn tek e ardhmja, Qalët nuk janë sugjестive, po të sakta, dija i ngjan megjithatë një filozofie, së cilës i mungon epistemologjia, por kurrësi jo mesianizmi etnik e antropologjik dhe panteizmi kozmik i infinitit është një prani si e dashurisë përvëluese dhe e pllenimit të gjithëmbarshtëm, të pakufizuar. Naim Frashëri është njeriu i rrallë shqiptar, por edhe ballkanik, njeriu i njerëzimit brendapërbrenda protagonizmit të tij historik. Figura e tij e plotësuar më kujton kalorësit e lashtë kinezë, që ishin edhe poetë edhe ekspertë për magji, interpretues të imagjinatave, për profetizim, astrologji, numerologji, që quheshin “fang-shih”, d.m.th. ushtrues të shkathësive okulte (të fshehtësive). Naim Frashëri është më tepër poeti i mistikës sesa mistiku i poezisë në këtë monadë ndërmjetëse dhe të mëvetshme të bektashizmit botëror dhe shqiptar. Ky bektashizëm është gati kozmologji dhe etikë dhe është një çudi e praktikës (pa vulgarizuar si pragmatizëm pozitivist), që kur mistika bektashiane u shndërrua, u trupëzua, nga subjekt u bë edhe objekt i shqiptarizmit (kam parasysh shqiptarizmin naimian). Unë s'rrri dot indiferent, po as i njëanshëm. Libri im për Naim Frashërin dhe bektashizmin është më tepër një paraqitje, një shpalosje, kaleidoskop i ideve, i shkruar krejt lirshëm, pa paragjykime letrare ose doktrinare, madje kështu edhe duhet lexuar ky libër. Ritmi i brendshëm i fjalëve është muzikë e dashurisë, një lloj meshtarie letrare, e qëllimtë dhe metonimike. Libri im e ka nismën te një figurë gjeniale paraardhëse: Pjetër Bogdani, i cili në kryeveprën e vet zhvillon teorinë e famshme mbi katër kuptimet me formulën klasike të evropianizmit latin mesjetar që thotë: “litera (sensus historicus) gesta docet, queid credas, allegoria, moralis, quid agar, quid speras, anagogia”. Bogdani i shqipëron poetikisht kështu:

*Historia mëson ndodhitë: ç 'ka beson alegoria,  
ç 'ka vepron tropologjia, se shpëren anagogia.*

Është e lehtë të vëresh e të mësosh se historia na stërvit në bazë të përvojës, alegoria është kërkimi i kuptimit për ndodhitë, substancën historike, tropologjia nxjerr porosinë morale, kurse anagogia na ndihmon të gjejmë përfundimin dhe ligjin mistik. Më shumë nga të gjithë është ligji mistik, i cili har-

monizon dhe finalizon gjithçka. Kështu dallimi midis fjalëve të Zotit dhe fjalëve njerëzore bëhet dallim i ndërlydhur dhe hermenautika transhedentale shfaqet si dituri. Ka një ngjashmëri tmerruese, por të vërtetë, midis katër kuptimeve të konceptit perëndimor të stilistikës mesjetare me kuptimet gjithashtu të ndërlykuara dhe me shumë nënshtresa të fjalëve dhe të stilistikës mesjetare lindore. Imam Aliu i paraprin tërë institucionit hyjnor të imamëve, ai konceptohet si një figurë e dritës, madje si një etnitet parakozmik dhe parajetë. Është imam Aliu i cili bëhet strukturë e ardhjes së Kaimit, imamit të ringjallur. Për Naim Frashërin, imami i ringjallur është imami i dymbëdhjetë. Hagjeografia e imamit të dymbëdhjetë është tepër misterioze, ai është “i papashëm me shqisat”, është plot tipare simbolike që kanë të bëjnë me lindjen dhe rrëmbimin e tij. Ky imam është zhdukur papritur, kur ishte djalë i ri dhe jeton tashmë kohën e zhdukjes së madhe (Gajbakubra). Perceptimi teofanik i tij, sipas mistikëve bektashianë, bëhet duke e njohur imamin e ringjallur vetëm me anë të zemrës. Nga kjo pikëpamje doktrina e bektashianëve për imamin e dymbëdhjetë i ngjan “Apokalipsit” të shën Gjonit, është një filozofi profetike, është misteri i antropologjisë hyjnore. Sipas bektashianëve, 17 persona do të ringjallen gjatë rishfaqjes së imam Mehdiut (imami i dymbëdhjetë), për arsye se janë 17 shkronja mistike, prej të cilave përbëhet profecia e këtij imami. Besoj se krahasimi metodik me kabalën hebraike është i qartë, ajo bazohet në dialektikën e negativitetit të dyfishtë, në kohën ciklike, ku hyjnorja dhe tokësorja alternohen, sipas dukurisë astronomike që emërtohet si “kreu dhe bishti i Dragoit” (pika në të cilën puqet orbita e Hënës dhe e Diellit), kështu “drama në qiej” bëhet pasqyrë dhe parafjalë e “tragjedisë në tokë”. Mistiku arab Ebu Jakup Sigistaniu, që ka jetuar në shekullin X, arriti që në katër cepat e kryqit të krishterë të zbulonte katër fillime fjalësh të fshehta, që paralajmërojnë paraqitjen e imamit të dymbëdhjetë në Natën e Kadrit (Ajeti 97), që është nata e njerëzimit mbi ciklin e zhdukjes. Këto fshehtësira dhe sekrete i ka ditur shumë mirë Naim Frashëri. Ai e ka farkëtuar me floririn mistik realitetin. Thirrja e tij, jo vetëm poetike por dhe apostolike, për malet (“O malet e Shqipërisë...”) ka të bëjë me dy malet që përmend edhe “Kurani”: mali i Urtësisë dhe mali i Dashurisë. Në këto male “shpirti i shpirtit” ngrihet si dru ulliri mistik në lartësitë e padukshme të Sinaut të dashurisë, por është urtësia prijëse që çon te fshehtësia e teofanisë (ashtu si Virgjili udhëheq në udhëtimin marramendës Danten drejt Beatrices





së dashurisë). Naim Frashëri ka ditur dhe historitë intelektuale të mëdha të mistikëve të paharruar. Në librin e tij në persisht “Ëndërrimet”, në poezinë “Në breg të detit” ai shkruan dhe këto vargje:

*Deti, qielli edhe shpezët dhe blerimi,  
Gjithë drurët, gjithë gjethet dhe burimi,  
Po vallëzojnë e ligjërojnë sot nga zjarri,  
Thua se janë Mensuri te litari.*

Po kush është Mensuri? Pse e përmend Naimi Mensurin? Mensuri i njohur me emrin e plotë Hysen Bin Mensur El Hallaxhi ka jetuar në shekullin IX, i lindur në qytetin Bejza të Persisë dhe i rritur në rininë e tij në qytetin Vasit të Irakut, jetoi më pas në Basra, në Bagdat, si dhe bëri udhëtime të shumta, shkoi tri herë me radhë në pelegrinazhin e shenjtë të Qabesë. Ky njeri me një intelekt të jashtëzakonshëm dhe me ndjeshmëri të lartë që vetë sakrifikues, nuk e njihte frikën. Ai shkroi shumë libra, dhe theksonte se ka dy lloj shkronjash, ose alfabetesh shkronja dhe alfabetë të krijuara nga njerëzit dhe shkronja dhe alfabetë të përjetshme të pakrijuara dot nga njerëzit. Dituria e madhe e tij i hutonte bashkëkohësit. Ai u shpall si heretik i rrezikshëm për shkak

të fjalëve të famshme të tij “Ene- El Hak”, që do të thotë “Unë jam Zoti” (në latinisht: Ego sum Deus). Mensuri në këtë mënyrë donte të shprehte njehsimin e tij me Zotin. Pasi e kalbën në burg për shumë vjet në Bagdat, kundërshtarët e tij e ekzekutuan në një ceremoni publike. Në fillim i prenë duart, më pas këmbët, i copëtuan kraharorin, i nxorën sytë, por prapë ai mundi të klithte: “Ene- El Hak”, i prenë gjuhën mëkatore, por vetëm kur i prenë kokën ai nuk mundi më të lëvizte në mënyrë rebele. Kufomën e tij e dogjën në zjarr dhe hirin e hodhën në lumin Dixhle të Bagdatit dhe legjenda thotë se lumi mbeti i purpurt për tre vjet me radhë. Por përveç atyre që e akuzuan Mensurin për blasfemi, pati edhe ithtarë të fuqishëm dhe gjenialë që e mbrojtën. E famshme është mbrojtja që i bëri Mensurit, Xhelaledin Rumi. Shkaku i fatkeqësisë së Mensurit nuk është vetëm se tha fjalët “Ene- El Hak”, por edhe sepse kishte thënë një ditë te mjedisësit e habitur, madje të llahtaritur, se nëse do të takonte profetin Muhamet, do ta pyeste: Pse Natën e Miraxhit kërkoi ndjesën e Zotit vetëm për besnikët e tij myslimanë dhe nuk e kërkoi për gjithë njerëzimin mbarë,

qofshin të mirë ose mëkatarë, e se po ta kërkonte këtë, me siguri nuk do t’i që kthyer fjala prapa dhe nuk do t’i që kursyer dhurimi. Naim Frashëri e përfytyron valen e të gjithë universit e krahasuar me çastin e paravdekjes së Mensurit. Ai i ka lexuar librat që kundërshtarët dhe mbrojtësit, në mënyrë antagoniste dhe të egër, pa asnjë kompromis, kanë shkruar për Mensurin. Por njohja e mistikës nga ana e Naim Frashërit ka karakter funksional për bektashizmin. Dihet se Haxhi Bektashi ka folur për esencat trifarëshe: esenca e domosdoshme, që është esenca e Zotit e që s’ka as fillim dhe as fund, esenca e mundshme, që është esenca e çdo krijese të Zotit, së cilës i dihet fillimi dhe mbarimi i saj si dhe esenca e pamundur, që do të thotë të jesh një shok i Zotit, çka është e pamundur dhe s’mund të ngjasë, sepse Zoti nuk mund të dyzohet. Por nuk mohohet teoria e Njësimit, e shkrirjes së njeriut të Zotit, por dhe e Zotit të njeriut. Adhurimi i Naimit për Mensurin shpjegohet vetëm me Njësimin. Libri im për Naim Frashërin dhe bektashizmin synon të jetë një libër konceptual, ku shpjegimet nuk vulgarizohen, sepse thjeshtëzimi do të ishte diçka e papranueshme, madje e neveritshme për mua. Mund të them se bektashizmi naimian përherë më duket kaq i habitshëm, saqë mezi e mbledh mendjen dhe veten time në përsiatjet për këtë temë të veçantë, ku ideja universale e Zotit është më e fuqishme dhe sa herë e tjetërsuar në raport me vetë institucionet fetare. Fjala vjen, ja disa vargje të skajshme dhe të guximshme të Naim Frashërit:

*Dhe ju hoxhë e ju dervishë,  
Mos shihni xhami e kishë,  
Si kisha është dhe xhamia,  
Tekdo është Perëndia.*

Pra, karakteri institucional, tokë-





sor i feve është i një rëndësie më të vogël sesa rëndësia jointucionale e Zotit në vetvete. Por vargjet e Naimit të kujtojnë moton e rreptë dhe kryengritëse të Vaso Pashë Shkodranit që iu drejtohet shqiptarëve:

*Dhe mos shikoni kisha e xhamia,  
Feja e shqiptarit është shqiptaria.*

Koncepti i shqiptarisë nuk duhet marrë si një kufizim etnik apo një nacionalizëm në formën e një enklave apo si një monadë shpirtëror dhe politike. Të paktën të Naim Frashëri shqiptarizmi është në palcën e humanizmit botëror. Në këtë vështrim vetë bektashizmi, si një shkrimje jo vetëm bashkuese, por dhe përjashtuese (p.sh. bën një ndarje të qartë midis institucioneve fetare dhe vetë thelbit ekumenik shpirtëror të feve), lidhet jo vetëm me shqiptarizmin, por dhe me humanizmin dhe me njëfarë mesianizmi shoqëror në formën e një ideje të pavarur dhe të përjetshme të filozofit Platon. Por bektashizmi naimian, ndonëse buron nga misticizmi islam dhe ka statusin e një sekti të veçantë ose të një tarikati, nuk e pengon Naim Frashërin që të ndjehet edhe si një i krishterë i mirëfilltë. Përveç një vjershe të veçantë për Jezu Krishtin, Naim Frashëri, që herët, tek libri “Ëndërrimet” shkruan edhe këto vargje në një figuracion të shkëlqyer, vargje të një moderniteti poetik:

*O ti det, që jep flladitje e gëzim!  
Tek ti gazin ma gjen zemra, shpirti im.  
Pika jote është e veprave t mëria,  
Ato - Krishti, kurse ti je shën - Mëria.*

Te Naim Frashëri, si tek asnjë shkrimtar apo intelektual shqiptar, ekziston kuptimi i dyzuar i paradoksit, çka e bën atë një projektues, në largësi dhe në të ardhmen, të etikës së jetikës së dëlirësimit apo të një katarsisi aristotelian. Nëse dogma e vetëkuptueshme e zanafillës se Zoti e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së tij, do të kishte fuqi prapavepruese, fuqi të mëpastajme, atëherë filli i arsyetimit tonë do të thyhej, do të deformatohej, kështu kuptimi i zanafillës do të kthehej në një kundërkuptim pas zanafillës. Ç’do të thotë ta krijosh njeriun sipas shëmbëlltyrës së Zotit, ku qëndron përgjegjësia e vetë Zotit për krijimin e tij? Këto janë pyetje të ngatërruara dhe jo shumë të qarta. Naim Frashëri nuk mënon të na tronditë kur shkruan:

*Edhe engjëlli edhe djalli,  
janë bashkë tek i gjalli.*

Tregimi biblik, por dhe ai kuranor theksojnë mono-teizmin, Zotin e vetëm. Kundërshtohet vdekshëm dhe deri në fund ideja e një Zoti të dytë. Në të vërtetë njeriu, si shëmbëlltyrë e Zotit, duhet të fillonte dhe

të mbaronte vetëm me Zotin. Kjo do të përcaktonte homogjenitetin e tij. Por ky homogjenitet nuk ekziston, përveç se si mundësi. Dualizmi i së Mirës me të Keqen bën që kjo kontradiktë morale

të krijojë kontradiktën gjithashtu antagoniste të Zotit me Djallin. Kështu, çdo monoteizëm fetar, pa përjashtim në të gjitha fetë e mëdha botërore, është në thelb dualizëm fetar. Nuk ekziston vetëm

Zoti, pra ai nuk është I vetmi, por ka një kundërshtar gjithashtu të pavdekshëm, që është Djalli. Atributi i pavdekshmërisë nuk i takoka vetëm Zotit dhe Hyjnores, por dhe Djallit dhe Antihyjnores.

# MOIKOMI YNË

**Nuri Çuni**

Ikja e Moikom Zeqos na trishtoi të gjithëve, por mbetet në zemrat tonë në jetë të jetëve. Jam njohur nga afër kur erdhi në Skrapar në aktivitetin e madh “Ditët e Tomorit” që e organizuam me Qendrën Kulturore të Skraparit, në gusht të vitin 1998. Moikomi ishte me mikun e tij Arian Leka, Xhevahir Spahiun, Dritëro Agollin, Shaban Sinanin dhe intelektual, studiues nga Akademia e Shkencës, Instituti i Kulturës Popullore, Universitetit Shtetëror të Tiranës. Pjesëmarrës në konferencën shkencore, ekspozitën fotografike dhe promovimin e librit “Këngët e Skraparit”, ai dha ndihmesë me kumtimin për malin e Tomorit dhe shprehu vlerësimin mbi etnokulturën e pasur të trevës në fjalë. Midis të tjerave Moikomi shkruan: “Nuk dihet se kur ka nisur të praktikohet ngjitja e Malit të Shenjtë si një festë për të gjithë njerëzit, me ngjyrë, besime dhe madje me gjuhë të ndryshme. Dikur para Erës së Re besohet se ka nisur gjithçka. Për vetë vetitë që besohet të ketë ende Mali i Tomorit, paganët e dikurshëm vendosën që çdo verë të caktoheshin pesë ditë nderimi për të dhe misticizmin e tij. Më vonë, pas daljes së kalendarit romak, rastisi se festa e ngjitjes së Malit dhe therjes së bagëtive si kurban të fillonte më 20 gusht dhe të përfundonte të paktën zyrtarisht më 25 të këtij muaji. E ngjizur si festë e bektashinjeve, në fakt, këto ditë duket se festa është për të gjithë. Nga të gjitha viset e Ballkanit, historikisht kanë pelegrinuar me mijra njerëz, vetëm e vetëm, që të jenë të pranishëm në vendin aq të shenjtë dhe mistik. Dhjetra janë edhe emrat e njerëzve të njohur të letrave të artit dhe

të shkencës shqiptare që kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në Ditët e Tomorit. Festa nisi me një ekspozitë pikturë të hapur në qytetin e Çorovodës, konferencën shkencore dhe me një sërë veprimtarish të tjera artistike dhe përkujtimore, të planifikuara dhe të programuara që më parë deri në detajet më të vogla. Ditët e festës së Tomorit – ato organizohen çdo vit – mbledhin në majën e malit të lartë dhe të shenjtë jo vetëm pelegrinët shqiptarë të brenda kufijve territorialë, por edhe ata të Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë, SHBA- së. Por edhe nga Italia, Spanja, Greqia, Gjermania, Kroacia dhe Izraeli etj. Të gjithë paskëtaj, pa ndonjë dallim të madh me njëri-tjetrin i hipin kurrizit të Malit Plak, bëjnë kurbanet dhe kthehen sërish në shtëpitë e tyre, çuditërisht me një ndjenjë lehtësie në shpirt.

Periudha parabizantine, tepër e gjatë dhe e lakueshme me të dhëna mitologjike dhe historike, nis të paktën që nga epet e Homerit, ku përmendet emri i malit të Tomorit. Më pas të dhënat e Strabonit dhe të autorëve të tjerë antikë, por edhe të ndonjë poeti të veçantë, si Theopompi, flasin për karakterin kultik të malit Tomor, që studiuesit e lidhin me emrin e malit Tomor.”

Jeta dhe vepra e tij është një jetë plot punë dhe veprimtari

e gjithanshme deri në çastet e fundit. Ai nuk e ndau bashkëpunimin me ne asnjëherë. Kryegjshata Botërore Bektashiane humbi mikun e vyer dhe bashkëpunorin e përhershëm në kontributin e tij për bektashizmin. Moikom Zeqo në udhëtimin e 71 jetëve të tij është i madh: si gazetar dhe redaktor letrar, mësues, punonjës shkencor pranë Muzeut Arke-





Kjo luftë kozmike e makrokozmosit është një luftë e pandalur e mikrokozmosit edhe brenda njeriut. Naim Frashëri, në vargjet e mësipërme shpreh në thelb dualizmin si antagonizëm moral

dhe fetar. Ai është në harmoni me zarathustrizmin persian. Ky zarathustrizëm nuk mund të shmanget as nga bektashizmi. Mbështetje shpirtërore e teologjisë dhe e filozofisë së ekzistencës së dervishëve

dhe të tarikateve mistike ka qenë gjithmonë zarathustrizmi. Në librin e liturgjisë së zarathustrizmit lartësohet kulti "i shpirttrave të të vdekurve" me termin "fravashije". Vargjet në persishten e vjetër

ologjik të Durrësit, specialist në sektorin e artit antik në Akademinë e Shkencave në Tiranë, Kryetar i Komitetit të Kulturës, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, deputet i PS-së dhe drejtor i Muzeut Historik Kombëtar. Asnjëherë nuk e ndali punën studimore si arkolog, për historinë e artit, si dhe të një numëri skenaresh për filma kinematografikë e televiziv me karakter arkeologjik dhe kulturor. Dr. i shkencave dhe titullin "Mjeshtër i Madh", ka marrë disa herë çmime të para për librat e tij, autori i 70 librave, midis tyre kontriboi për bektashizmin me "Princwrit e Mistikës", "Syri i Tretë". Ka marrë pjesë në simpoziume, konferenca shkencore ndërkombëtare për bektashizmin të drejtuara nga

Kryegjyshata Botërore Bektashiane. Krijime të Moikom Zeqos janë përkthye në 12 gjuhët. Veprat e tij dallohen për një stil lakonik, të ngjeshur dhe erudite, mbahet si pionier i postmodernizmit në letrat shqipe. Pjesëmarrja në homazh dhe varrimin e tij nga përfaqësues të Kryegjyshit të Botërore Bektashiane ishte një mesazh dhe mirënjohje e veçantë për mikun tonë të vjetër.

Plotë emocion të veçantë ishte vizita e familjes së tij, të shoqes Lida, djalin Epidamnit dhe dy vajzave të tij, Arnisa dhe Kleitia me bashkëshortët hollandezë, në Selinë e Shenjtë, përfaqësuesit e tarikatis kadri dhe rufai me sheh Bujar Horasani dhe sheh Qemaludin Reka. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e

Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, priti me shumë dashuri të afërmit me ngushëllimet për këtë humbje të madhe të Moikom, duke u shprehur: "Ai kaloi nga jeta, por është këtu midis nesh dhe nuk do të harrohet kurrë. Moikom i kemi patur gjithmonë pranë në aktivitete të ndryshme, ndihmesën me kumtesat dhe dy librat për bektashizmin, "Princërit e Mistikës" dhe "Syri i Tretë", mendime për "Muzeun e Bektashizmit", figura e Pirit të Dytë të bektashizmit "Ballëm Sulltani" e kishim para disa kohësh midis nesh kur u përurua ekspozita e pikturës "Kaleshi", promovimin e librit "Ujët e Jetës" dhe e donim dhe na donte shumë." Me këtë rast Kryegjyshi i dha djalit të tij Mirënjohjen (pas vdekjes)

Moikom Zeqos për vlerat dhe kontributin që ka dhënë për bektashizmin. Gjithashtu u shpërndau pjestarëve të familjes medialione të dede Ahmetit dhe dede Reshatit. Familja shprehu mirënjohjen dhe falenderimin për Kryegjyshin dhe Kryegjyshit të Botërore Bektashiane për vlersimin e njeriut të tyre të dashur dhe do të bashkëpunojmë



edhe në të ardhmen me institucionin tuaj duke pasqyruar vlerat e bektashizmit në fondacionin e përsakrijuar "Moikom Zeqo dhe kujtimet tuaja për të. Moikom Zeqo mbetet një enciklopedist i rrallë i kulturës shqiptare dhe erudit, një mik i përjetshëm i bektashinjve.

lexohen me zë të lartë dhe ritualisht deri në stërlodhje, deri në mpirje, deri në ekstazë. Këto vargje parakuptojnë kultin e martirëve të mëdhenj të Lindjes, por dhe kultin e martirëve të mëdhenj të Perëndimit. Kulti i shenjtëorëve mistikë është veçanti e bektashizmit. Në

eposin e Qerbelasë Naim Frashëri shkruan vargje vlerësuese të larta për profetin Muhamet. Unë, krijuesi i këtyre rreshtave, kam mundur të kuptoj madhësinë e profetit Muhamet kur kam lexuar librin e famshëm të Karlajt, i cili e përgjithëson Muhametin si një

kryehero të revolucionit fetar. Me nderim për të flasin dhe Gëte dhe Lamartini. Nuk mund të harroj të tërë orientalistët e botës, që s'mund të jenë të tillë nëse nuk flasin për profetin Muhamet, jo thjesht në aspektin biografik të profetit, por edhe për revolucionin.

# PANDEMIJA E SOTME DHE QASJA PROFETIKE

**Edison Hoti**


Situata në të cilën gjendet vendi ynë këto ditë por edhe e gjithë bota mbarë, e sunduar nga pandemia botërore e coronavirus, është një situatë mbi të cilën në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte janë të prekur të gjithë. Për shumë nga ne është një situatë e veçantë dhe e panjohur, por bota ka kaluar shumë të tilla dhe me pasoja shumë të rënda për njerëzimin. A mund të parandaloheshin këto situata, a mund të merreshin më tepër masa mbi shmangien e këtyre epidemive, a mund të bënte me tepër mjekësia parandaluese, ne nuk do të qëndrojmë mbi këto tema, por do të sjellim një pjesë të këndvështrimit Profetik mbi çështjen, do të përmendim shkurt se si Profeti ynë (a.s.) e bënte këtë analizë që nga njohja e problemit, masat mbrojtëse dhe menaxhimi i problemit.

Ekzistencën e mikrobeve në ditët e sotme ne mund ta shikojmë shumë thjeshtë me anë të mikroskopit. Kemi shumë njohuri dhe informacion rreth tyre. Dimë që disa nga këto mikrobe kanë aftësinë që mund të çojnë deri në sëmundje fatale vdekjeprurëse. Ndërkohë ekzistencën e këtyre mikrobeve e gjejmë që herët në thëniet e Profetit Muhamed. Në një hadith të transmetuar nga Ebu Musa El-Eshari Profeti ynë thotë: “Ummeti im zhduket me shpatë dhe taun.” Shokët e tij e pyesin: “Ne e njohim shpatën o i Dërguar i Allahut; por çfarë është taun? “Zotëria ynë ua përshkruan kështu: “Është i fshehtë

për syrin ashtu siç është edhe xhindi, godet në fshehtësi pas shpine si armiku. Prej tyre fitohet sevapi i shehidit (dëshmorit).” Ebû Davud, Müsned. Profeti ynë bëri disa sugjerime për mbrojtje nga sëmundjet infektive, si dhe pastrimin e trupit dhe mjedisit. Kur e shikojmë në dritën e këtij informacioni, shohim se Muhamedi ynë (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të) ishte i pari që përshkroi mikroorganizmat. Ai theksoi se murtaja është një agjent i dëmshëm që nuk mund të shihet me sy të lirë, përhapet në fshehtësi, dhe karantina është e nevojshme për të parandaluar përhapjen e sëmundjes. Ai gjithashtu nënkuptoi që këto lloj mikrobesh transmetohen në trupin e njeriut nga jashtë.

Profeti jep disa këshilla për parandalimin e përhapjes së këtyre mikrobeve. Vendos dorën, kur të hapet goja. Shumica e sëmundjeve të mushkërive shkaktohen prej infeksioneve të cilat mund të merren me anë të mikrobeve të marra nga rrugët e frymëmarrjes. Mikrobet që gjenden në ajër në momentin që marrim frymë thellë nëpërmjet bronkeve zbresin në mushkëri dhe kjo mjafton të bëhet shkak për sëmundje. Ai, këshillon: “Kur dikujt nga ju i hapet goja, të vendosë dorën para gojës.” (Ebu Davud, Muslim, Musned) Gjatë hapjes së gojës, duhet të mbyllim gojën në mënyrë që mikrobet të mos kalojnë bajamet dhe të vendosen tek qeset e ajrit. Kështu, në këtë mënyrë, ne parandalojmë sëmundjet që mund të transmetohen në traktin e sipërm dhe të poshtëm të frymëmarrjes me anë të ajrit.





Në shekullin XIX, pasi grimcat e pluhurit dhe mikroorganizmat u panë me mikroskop, të kuptuarit e distancës midis pacientit dhe njerëzve të shëndetshëm u përfshi në bazat e mjekësisë. Për herë të parë në historinë e mjekësisë, Zotëria ynë për çështjen e distancës midis pacientëve do të shprehej: “Shmanguni nga të sëmurët me lebrozë sikur të shmangeshit nga kafshët grabitqare. Kur levra zbret në një luginë, ju ikni në një luginë tjetër. Mos i vizitoni vazhdimisht pacientët me lebrozë. Kur të flisni me ta, duhet të ketë një distancë prej një ose dy shtiza midis jush dhe atyre.” (Musned, Ibn-i Maxhe). Sot, autoritetet mjekësore rekomandojnë që kjo distancë të mos jetë më e vogël se 70-80 cm.

Gjatë historisë, miliona njerëz kanë vdekur nga murtaja (taun), ethet, malarja dhe sëmundje të ndryshme virale që kërcënojnë njerëzit, duke shkaktuar vdekje masive. Përhapjet masive që kanë ardhur në shekujt e kaluar, gjithmonë mbahen mend me tmerr. Le të dëgjojmë fjalët e Pro-

phetit tonë në lidhje me këtë: “Nëse dëgjoni se ka një sëmundje taun diku, mos shkoni atje. Nëse dëgjoni se ka një sëmundje taun aty ku jeni ju, mos dilni nga atje për të shpëtuar nga sëmundja. “Një person i cili largohet nga kjo karantine në këtë vend ka mëkatuar si ai që largohet nga lufta. Ai i cili vdes duke qëndruar aty ku e kishte origjinën taun ka shpërbimin e shehidit (martirit).” (Ebu Davud, Musnad). Profeti e përshkroi karantinën me kuptimin e saj të plotë dhe garantoj zbatueshmërinë e saj me thëniet e mësipërme. Ai e krahasoi personin që largohet nga karantina me këdo që dezerton nga lufta dhe u kujtoi njerëzve pasojat e arratisjes nga lufta. Ai rekomandoi karantinën për të parandaluar njerëzit e sëmurë të infektojnë të tjerët me sëmundjet e tyre, si dhe të ndalojnë bashkimin e kafshëve të sëmura me kafshë të shëndetshme. Në një transmetim të hadithit profetik thuhet: “Kafshët e sëmura, nuk duhet të bashkohen nga pronarët e tyre me ato që janë të shëndetshme”.

(Buhari, Muslimi, Ebu Davud). Për secilën epidemi si taun, malarja, fruthi etj., pavarësisht nga lloji i epidemisë, Zotëria ynë urdhëron e thotë: “Të afruarit me çdo sëmundje përmban rrezik”. (Ebu Davud). Pra shihet edhe një herë theksin e kujdesit që duhet të kemi ndaj çdo lloj epidemie, virusi apo sëmundjeje.

Profeti ynë, dorën e djathtë e përdorte për të ngrënë dhe për punë të pastra, ndërsa e përdorte dorën e majtë për të pastruar papastërtitë. (Ebu Davud). Nëse pastroni kokën, gojën, hundën dhe lëkurën me dorën e majtë të kontaminuar, ju padashur ndotni zona të pastra, gjë që është kundër parimeve shëndetësore. Kur shqyrtohet historia e mjekësisë, kuptohet që Zotëria ynë është emri i vetëm që bën ndarjen e detyrave për duart tona. Ai rekomandoi të përdorni dorën e majtë në të gjitha punët e papastrat dhe dorën e djathtë në punët e pastra. Profeti ynë pëlqente të fillonte gjithmonë nga e djathta me pastrimin, krehjen apo edhe veshjen e këpucëve (Buhari,

Muslimi). Dhe me dorën e majtë duhet të prekim mbeturinat e trupit, ose organet nga të cilat ato burojnë. Kështu, ne nuk kontaminojmë pjesë të pastra të trupit me mikroorganizma që shkaktojnë sëmundje.

Ebu Hurejra (r.a.) tregon: "Kur Pro-

selem) është një sjellje e mrekullueshme që frymëzohet nga një lloj zbuluese hyjnore, si kërkesë e urtësisë hyjnore, për të mbrojtur njerëzit në mjedise nga sëmundjet infektive. Në transportimin e ushqimeve, sidomos ato që janë të hapura mund të infek-

pijeve të jenë të mbyllura dhe të pastra është gjithashtu shumë e rëndësishme për shëndetin. Në të vërtetë, Profeti Muhamed tha: "Mbyllini dyert (ndërsa shtriheni për të pushuar në mbrëmje). Mbulojini enet e ujit. Kthejeni enët boshe me kokë

## ERVIN BEJKO, një misionar i heshtur

**D**ymbëdhjetë vite më parë, ndërsa ndiqnim plot shqetësim ecurinë e zemrës së myrshidit tonë, dede Reshat Bardhi, në një prej spitalëve të Tiranës, ai u shfaq i heshtur. Dëgjoji dy – tri mjekë, u mendua, vajti pranë shtratit të sëmurit dhe pastaj me zërin e butë, por të sigurt, na tha se atë natë do t'i rrinte vetë tek koka, dede Reshatit. Ndër mjekët reanimator të mrekullueshëm të spitalit "Nënë Tereza" ndonëse nuk e kish për detyrë, ai zgjodhi sfidën, përgjegjësinë, që buronte sa prej betimit emblemantik të Hipokratit, aq edhe prej dashurisë njerëzore që ushqente për Kryegjyshin Botëror Bektashian. "Unë nuk jam myhib, më tha me buzën në gaz, unë nuk e njoh konstruktin shpirtëror të mejdanit të teqesë, unë njoh simbolikën e perceptimit bektashian për vëllazërinë. Dede Reshati edhe në këto momente shpërndan një shenjtëri të pazakontë... Misioni ynë, i mjekëve, ndonëse shumë fisnik, është tepër i vogël, përpara misionit të tij, të përcjellë dritë e paqe për milionat e besimtarëve në këtë botë dhe në tjetrën, të përjetshmen".

Këto fjalë i kam të skalitura në memorie. Ne ishim



tri katër njerëz nga më të afërmit e dede Reshatit dhe ai na siguroi të flinim gjumë të qetë, sepse do t'i rrinte vetë tek koka. Një përkujdesje gati prej myridi, e transformuar jo thjesht në një natë më tepër pa gjumë, por në një bashkëbisedim në heshtje midis të vërtetave të zemrës dhe të vërtetave të Zotit.

Dhe gati e pata harruar atë natë, kur në ekranin e një televizioni, fare nxitimthi, pashë misionin e heshtur, reanimatorin e pabujë që prej katër – pesë muajsh, u shërben të sëmurëve me covid-19, me sytë e qeshur, me dashurinë për jetën e tjetrit që kurrë s'e pati njohur, por që duhet ta mbajë medoemos në këtë botë. Ervin Bejko, si një model kreativiteti mund të ishte sot një mjek reanimator mjaft i përkëdhelur e mikluar në Evropë dhe në botë, sikundër me qindra nga armata e mjekëve, sidomos e brezit të tij. Ja që nuk ka ndodhur. Një trill i fatit, apo mesazh i gjenezës familjare, e mban ende në radhët e misionarëve të jetës njerëzore, këtu në vendin plot halle. Ndaj le t'u bashkohen këta rreshta mijëra urimeve të thëna e të pathëna për të, nga ata që admiruan kujdesin e tij.

**Syrja Xhelaj**

feti teshtiu, ai vendosi dorën dhe një pjesë të rrobës së tij në gojë dhe u përpoq të ulë zërin e tij". Ky veprim i Zotërisë tonë (salallahu alejhi ue

tohen me mikrobe me anë të mizave, insekteve, ajrit nëpërmjet teshtimave apo kollitjes.

Fakti që enët e ushqimit dhe

poshtë! Mbuloni enët e mbushura dhe fikni dritat! Sepse krijesat e dëmshme nuk e hapin derën e mbyllur. A nuk janë minjtë që mund t'ju shkatër-



rojnë shtëpitë e njerëzve?!“ (Buhari, Muslimi, Müfred). Ai rekomandon që enët e zbrazëta të kthehen përmbys ose kapakët e tyre të mbyllen, në mënyrë që asgjë të mos mund të futet në to. Nëse dikush kollitet në shtëpi, ata infektojnë enët e hapura. Gjithashtu, enët e ushqimit dhe pijeve duhet të mbahen të mbyllura për të parandaluar ndotjen bakteriale me kafshët shtëpiake, mizat, insektet dhe brejtësit. Profeti ynë gjithashtu e ndaloi këdo që të pijë në një enë ku mund të pinë edhe të tjerët. Nëse personi që pi ujë ka infeksione të traktit të sipërm dhe të poshtëm të frymëmarrjes, ai mund ta infektojë të gjithë enën dhe lëngun që përmban ena.

\*\*\*

Profeti ynë (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) deklaroi se duhet të punohet me kënetat që ato të mos ktheheshin në burime sëmundjesh, veçanërisht nga malaria. Kur Hz. Aishja arriti nga Meka në Medine, thotë që Medina ishte vendi me më shumë sëmundje në rajonin arab. Profeti ynë dha rekomandime për tharjen e luginës së Buthanit (Buhari, Muslimi, Dârimi, Mâce, K. Ummal, Ramuz, L. Ukul). Ndërsa, ashtu si çdo mysliman e mban shtëpinë e tij të pastër, duhet të mbajë pastër dhe ambientin përreth tij, gjithashtu edhe burimet e ujit. Profeti ynë i ka dhënë një rëndësi të veçantë pastrimit të ambientit përreth dhe myslimanët i kanë dhënë gjithmonë rëndësi kësaj praktike. Ai (s.a.s) e ndaloi urinimin poshtë pemëve, hijeve, burimeve të ujit, ujërave të ndenjtur, në rrugë, fole kafshësh dhe në vendstrehime të kafshëve. (Muslimi, Buhariu, E. Davud). Dikur pati thënë: “Mos u bëj nga ata që janë mallkuar”. Kur sahabët pyetën: “Kush janë këta?” Profeti ynë tha: “Ata që abdesojnë dhe ndotin rrugët, hijet, anët e ujit dhe nën pemë.” (Muslimi, Mace, M. Zevaid, Faik). Kështu, ai deklaroi se ata që ndotin ambientet e përbashkëta me pështymë do të bëhen

“lanet” në këtë botë dhe në botën tjetër duke dashur të eliminonte gjithçka që dëmtonte njerëzit dhe e konsideronte atë si një nga degët e besimit.

Profeti ynë (salallahu alejhi ue selem) nuk e pa të përshtatshme rritjen e kafshëve të sëmura në vende ku kishte grumbullime njerëzish siç ishte rasti i Haxhit dhe Umres. Njëkohësisht ai (salallahu alejhi ue selem) urdhëroi që të mos mbani qen, përveç qenit të gjuetisë, qenit të bariut dhe qenit të bujqësisë.

Ndërsa Kur ushqimet shtazore përdoren pa u gatuar siç duhet, ato mund të shkaktojnë helmim. Produktet e detit të pa gatuar mirë, mbeturina të aparatit tretës dhe urinës së kafshëve, produkte të mishit të gjallë të pagatuar, prekja e kafshëve dhe moslarja e duarve ose frymëmarrja në ambientet me mikroba bëhet shkak për sëmundje të tilla si tifoja, enterokoliti, pneumonia, murtaja, bruceloza, meningjiti. Për t'u shmangur nga këto sëmundje, mishi duhet përgatitur ashtu siç ka urdhëruar edhe Zotëria ynë. Ai në Haxhin e Lamtumirës, pasi u pre në kurbanet urdhëroi: “O Sevban! Merrni masa që mishi të mos mbajë erë dhe të gatuhet mirë.” (Muslimi, E. Davud, S. Kubra, K. Ummal).

\*\*\*

Ndërsa dihet se njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundje të ndryshme, sidomos nga sëmundjet e lëkurës nuk duhet të pranohen në ambiente të tilla si banjot turke (hamamet) dhe pishina. Në kohën e Profetit a.s, në Arabi nuk kishte hamam. Sidoqoftë, ai (salallahu alejhi ue selem) si një lajm nga gajbi thotë: “Një vend i panjohur për ju do të çlirohet së shpejti për ju. Aty do të gjeni shtëpi që quhen hamame. Atje burrat të mos futen pa rrobë, dhe gratë e sëmura ose ato që nuk kanë lindur të mos futen.” (S. Kubra, M. Mace, Bagdadi). Kjo sepse kishte rrezik që gratë e shëndosha të mund të merrnin ndonjë rrezik nga hamami.

Profeti ynë në lidhje me mosfutjen e burrave në banjë pa rroba ka thënë: “Kush beson në ditën e Ahiretit të mos futet pa rrobë në hamam.” (Bagdadi, Nesai, Müsned). Urdhëron ndalimin e hapjes së pjesëve private në ambiente të përbashkëta, për të shmangur imoralitete që mund të shkaktohen.

Sa u përmendën më lart, janë veçse disa pika uji në detin e madh të profetësisë. Sigurisht që nëse do të zbatoheshin rregullat e sjella nga Profeti ynë (salallahu alejhi ue selem), asnjë prej epidemive në histori nuk do të kishte ndodhur. Në fakt, edhe Organizata Botërore e Shëndetit pretendon se i njëjti rezultat do të arrihet me zbatimin e rregullave të pastrimit. Sidoqoftë, rregullat e sjella nga Islami bëjnë të mundur një jetë të pastër. Islami ka zbritur si fe që edukon mënyrën me të mirë të jetuarit midis njerëzve. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të jetojnë në një mjedis të pastër. Gjithashtu edhe për njerëzit të cilët jetojnë në vende të mbipopulluara, në vende ku ka organizime të mëdha shoqërore, udhëzimet dhe këshillat që ka dhënë Zotëria ynë (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të) do të mjaftonin deri në kiamet. Shpresojmë që me të vërtetë njerëzimi të kuptojë atë të cilit i janë dhënë çelësat e kuptimeve të kësaj bote dhe botës tjetër, ahiretit.

Ai i cili është mësuesi i dy librave të cilët shpjegojnë të njëjtën të vërtetë por me gjuhë të ndryshme, libri i universit dhe Kur'ani. Ku edhe njeriu i sotëm do të ishte në harmoni me vetveten, do të ishte në harmoni me shoqërinë, do të ishte në harmoni me mjedisin, do të ishte në harmoni me natyrën e krijimit që ka vendosur Krijuesi i Gjithësisë, i Cili na vendosi në këtë shtëpi të madhe të njerëzimit.

Receta mjekësore për një shekull të sëmurë, për një komb të sëmurë dhe për një gjymtyrë të sëmurë, është ndjekja e Kur'anit.

# Poezi

## Gjysh Bektash Kozeli

### Besim i plotë

Duke lutur Perëndinë,  
Me mëshirë e me dëshirë,  
Veçse Muhamet Alinë,  
Nuk gjeta më të mirë.

Gjithë botën e përzjeva,  
Përpjetë dhe tatëpjetë,  
Më shumë këta pëlqeve,  
Imamët, të dymbëdhjetë.

Këta gjeta të mbaruar,  
Në këtë dhe, në atë jetë,  
Këta janë të lëvduar,  
Nga Zoti i Madh, i vërtetë.

Këta janë më të parë,  
S'mund të ketë më të naltë,  
Këta janë më të lartë,  
Nga balta që nxjerrë mjaltë.

Këta janë të mbaruar,  
Të drejtë dhe të vërtetë,  
Këta janë të provuar,  
Që këthejnë këtë jetë.

Këta janë të bashkuar,  
Me shenjtorë e me profitë,  
Këta janë më ët çquar,  
Që na japin neve dritë.

Thonë që ka dhe buaj,  
Që e mbajnë këtë botë,  
Janë dymbëdhjetë muaj,  
Që e kthejnë këtë rotë.

Fis i Muhamet Alisë,  
Nga barku i Fatimesë,  
Shtyll' e lartë e gjithësisë,  
Që i kemi prurë besë.

Këta erdhnë nga Aliu,  
Të niprit e Muhametit,  
Këta janë si veriu,  
Që e ngreh dallgën e detit.

Këta ishin dhe më parë,  
Këta janë dhe të dytë,  
Këta kanë hedhur farë,  
Pa qenë hëna me yjtë.

Këta e kanë folenë,  
Mu në gji të Perëndisë,  
Nji e ujin, një e ngrenë,  
Kontrollimin e gjithësisë.

Këta kanë qëndruar,  
Mu në mes të njerëzisë,  
Dhe këta kanë luftuar,  
Me kombin e Jezidisë.

Këta quhen shenjtorë,  
Në tufën e Evlijasë,  
Këta u bënë therorë,  
Në fushëne Qerbelasë.

Sa profitë dhe shenjtorë,  
Të gjithë n'Qerbela qenë,  
Gjithë u bënë therorë,  
Bashkë me Imam Hysejnë.

Të gjithë bota i shihnin,  
Musanë, Harunë, Isanë,  
Hiç asnjeri nuk i njihnin,  
Mustafanë e Myrtezanë.

Ca nga këta fluturuan,  
Se ku vanë nuk e dijnë,  
Neve këta na dërguan,  
Në Shqipri Abaz Alinë.

Gjysh Bektashi është falë,  
Në Imamët dymbëdhjetë,  
Me zemër e jo me fjalë,  
Në këtë dhe n'atë jetë.

### Njeriut të mirë

O njeriu i njerëzisë,  
Të ngrihesh që pa gdhirë,  
Ti lutesh Perëndisë,  
Me mëshirë për të mirë.

Ke ardhur në këtë jetë,  
Shum'a për një copë herë,  
Rri i qetë e i vërtetë,  
Me zemër të larë, të gjerë.

Mirësia është e gjallë,  
Kurrë vdekje s'mund të ketë,  
Të nxjerrë ballë për ballë,  
Para Zotit të vërtetë.

Mirësia është dritë,  
Porsi dielli me të gdhirë,  
Nuk i afron ligësitë,  
Të çel mendjen e fiqirë.

Mirësia porsi bletë,  
Që të mbush qypin me mjaltë,  
Në këtë dhe n' atë jetë,  
E ka vendin të lartë.

Mirësia, Perëndia,  
Me urime, me bekime,  
Ligësia, djallëzia,  
Mundime e hidhërime.





# Baba Meleq Shëmbërdhenji

## Gjumi pa brenqë

Po dremitja papandehur,  
Kur më tundi e më thotë,  
Ç'ke që rri kështu i zbehur,  
Se gjumi po është kotë.

I gjori me vrap u zgjova,  
Po më dha vetë durime,  
Me të gjith' anë kërkova,  
Po qenka dëshira ime.

U luçë te Perëndia,  
Cili qe ky që më ngriti,  
E m'i kulloi ment' e mija,  
Të bënja fjalë s'më priti.

Zemra ime duke qeshur,  
Më tha e ke vetë brenda,  
Nuk rri jasht' i zhveshur,  
Sa të jesh s'të del nga tënnda.

Thashë më ngriti të dalë,  
Pse pshihet si Perëndia,  
E të ja them me ngadalë,  
Një nga fjalët e mia.

U hodh mëshir' e uruar,  
Më tha vetë e ke lipur,

Gjer tashti e ke kërkuar,  
Po të rrij' brenda tulitur.

U mestova gjatë e gjerë,  
Thashë munt Zoti më tundi,  
Po s'ma preu mendje mjerë,  
Pa atë s'ka vend gjëkundi.

Me durim jetë gjatë,  
Që e ka bekuar Zoti,  
Durova gjithë atë natë,  
E prej syve s' mu preh loti.

Meleq ku e kërkon tinë,  
Nënë dhet' a përmbi qiej,  
Sido që është po e ndjej.

## Zemrën ma ka dëlirë

Rrushi s'ish fare në jetë,  
Unë qelqen e piva,  
Pjesën ma dha Zoti vetë,  
Brenda në zemër e shtiva.

Shtirësit me sy i bëra,  
Të lutem mua më shtjerë,  
Nuk dua tjetër gjëra,  
Të jem vejtur kurdoherë.

Të mos tregoj gjithë ç'janë,  
Thash e themet e shkreta,  
Po të jemi ndarë më nj'anë,  
Me fjalë të vërteta.

Q'atë herë është ngjitur,  
Që më rri kjo pirje shumë,  
Mot për mot është rritur,  
Nuk e di ç'është kjo punë.

Ajo dejtje s'më ka dalë,  
Ndaj jam gjithnjë i pirë,  
Ma mbushi mendjen me fjalë,  
E zemrën ma ka dëlirë.

Shtirësi ish fort i bukur,  
Bukuroshi im i thashë,  
Mora leje dyke lutur,  
Ju fala, ndër këmbë rashë.



# Sufizmi si vlerë shpirtërore

Përgjatë shekujve në historinë e islamit në mënyrën më domethënëse sufizmi ka luajtur rolin e tij të veçantë. Ai ka mundur përmes shtresëzimeve kohore dhe konteksteve fetare të mbijetojë duke ruajtur devocionin brenda familjes së madhe muslimane. I bindur që sufizmi është rruga më e mirë, sufiu merr disa vendime në pikëpamjen e raportit të tij ndaj Zotit, njeriut dhe botës dhe pikërisht në dritën e këtyre raporteve edhe ndryshon prej të tjerëve: këto raporte paraqesin kriterin e dallimit të sufiut të vërtetë prej atyre që vetëm është menduar se janë sufij.

Prej këtyre tre tipave të raporteve, raporti i sufiut ndaj Zotit është më i rëndësishmi, për arsye se dy të tjerët, thënë më shkurt, janë derivate dhe i nënshtrohen këtij të parit. Kushejri nxjerr këto konkluzione të rëndësishme në lidhje me raportin e sufiut ndaj Zotit:

Çështja e parë dhe më kryesore është që besimi në Zot nuk guxon të ketë asnjë element të dyshimit. Ai nuk duhet të helmohet me nocione të reja helmuese dhe koncepte të prapa, dhe duhet të jetë fort i bazuar në fakte evidente.

Në këtë kontekst “dyshimi” nënkupton pa përcaktim rreth attributeve të Zotit dhe skepticizëm në raport me ekzistimin e Tij, ndërsa është e qartë që sufiu mund t’u ikë këtyre pa përcaktimeve dhe skepticizmave vetëm duke u mbështetur në atë që i ka ardhur përmes Kur’anit dhe Sunnetit. Që është kështu rezulton nga paralajmërimi kundër “nocioneve të reja helmuese” dhe “koncepteve të gabuara”. Çfarë nocione dhe koncepte kanë qenë mund të shihet lehtë nga ajo që Kushejri

dhe Huxhviri na ofrojnë me emërtimin Melahida, Keramita etj. Mirëpo, ajo që është më me rëndësi në këtë aspekt është theksimi që sufiu qëndron në argumentin faktik, ngase beson se konceptualiteti i pastër nuk është raporti i vetëm të cilin njeriu mund ta ketë me Zotin; ky raport mundet gjithashtu të jetë artificial.

Raporti i individit ndaj Zotit kështu do të jetë i tërësishëm dhe plotësues, sa që do ta shpjerë deri te ndjenja se jeton dhe bën gjithçka jo për shkak se ai do ta bënte këtë, por për atë që krejt këtë e bën Zoti. Në identifikimin e vet me Zotin ai do të kalojë nëpër procesin e dyfishtë të humbjes së vetësisë së vdekshme në Zotin dhe duke e shijuar Atë në çdo akt të vetësisë së vet. Prandaj, është e qartë që sufiu që nga fillimi synon të bëjë jetë për të cilën vërtet mund të thuhet se është jetë me dhe në Te.

Më pas, sufiu jo vetëm që pushon së interesuari për veprat e tij që kanë të bëjnë me vetësinë e vdekshme, porse ndërton qëndrim pozitiv se duhet ta pranojë vullnetin e Zotit si të gjithëfuqishme edhe atë jo vetëm në këta apo atë rast, as vetëm në këtë apo atë situatë të posaçme, por gjithnjë dhe në çdo moment të jetës.

Raporti i sufiut ndaj Zotit është raport i pastër: është raport midis tij dhe Zotit të tij pa kurrfarë lidhjesh materiale. Ky raport e liron njeriun nga të kryerit e punëve të përditshme dhe tokësore. Sufiu duhet ta konsiderojë veten krijesë të cilën nuk e ka krijuar askush tjetër pos Zotit.

Kur është fjala për njerëzit tjerë dhe botën në tërësi, sufijtë e hershëm e kanë theksuar në mënyrë



të prerë që sheriati është kornizë brenda cilës duhet ndërtuar dhe kultivuar këto raporte. Në lidhje me këtë kanë kërkuar nga çdo sufi të synojë të gjitha dituritë në të cilët është bazuar sheriati. Në veçanti është urdhëruar se duhet kërkuar ndritje në mënyrën në të cilën Pejgamberi i Shenjtë e ka jetuar jetën e tij, ashtu që sunneti të mund të bëhet dritë udhëheqëse për te, në gjithçka që bën dhe në të gjitha raportet që i ndërton. Ndonëse shkollat e ndryshme sufiste kanë dalluar njëra nga tjetra në bazë të modeleve të tyre individuale të teknikave sufiste, të gjithë kanë qenë unanimes në një nivel të përbashkët të mbështetjes përfundimtare, e ai ka qenë korniza e shariatit.

Krahas kërkesës që për çdo sufi mbështetje përfundimtare dhe masë gjithnjë duhet të jetë sheriati, sufijtë e hershëm rrallë kanë lëshuar të theksojnë se ai që nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme shariatit vetveten e shtyn në konfuzion dhe kontradiktë; ata gjithnjë janë përkujdesur që qëndrimet e tyre dhe pozita të jenë qartë të ndryshme nga ato të dijetarëve dhe teologëve ortodoksë si dhe nga ato të risimtarëve dhe sofistëve.

Dallimi ndërmjet qëndrimit të sufiut dhe teologut ortodoks qëndron në atë që teologu ligjin dhe realitetin e konsideron një të njëjtë, gjersa sufiu mendon që këto dyja janë aq të ndryshëm, sa nëse dikush nuk mund të shikojë ndryshimin thuaja ka bërë mëkat.

Realiteti nga ky qëndrim është një aspekt i posaçëm i Zotit, ashtu që njeriu nuk mund ta kuptojë kurrë në tërësi, gjersa sheriati është rregull i sjelljes së njerëzve të cilën njeriu mund dhe duhet të përpiqet ta kuptojë dhe të veprojë sipas tij sa më shumë që është e mundur.

Identiteti i realitetit dhe shariatit të cilin sufijtë ia përshkruajnë teologut nuk është aq lehtë të kuptohet. Sipas asaj që qëndron në veprat e prijësve të katër shkollave të fikhut, dikush do të mund të deklaronte se teologu është shumë logjik dhe i vëmendshëm në komentimin e tij të attributeve të Zotit; ai do të ishte personi i fundit i cili do ta identifikonte shariat-in dhe hakikat-in, ngase duke pasur parasysh që të kuptuarit e shariatit nuk kërkon aftësi më të madhe se të njeriut të zakonshëm e cila kërkohet për zgjidhjen e problemeve të tija nga jeta e përditshme, të kuptuarit e hakikat-ti kërkon aftësi të veçantë të cilën e posedojnë vetëm të dërguarit.


Kur bëhet fjalë për dallimin në mes sufijve dhe risimtarëve e sofistëve, është theksuar se, gjersa sufijtë pohojnë që sheriati dhe hakika-ti, përkundër dallimit teorik midis tyre, gjithnjë janë të lidhje të ngushtë, risimtarët deklarojnë që sheriati është operativ vetëm përderisa njeriu nuk ka kontakt të fortë me realitetin: sa herë që ky kontakt vendoset, përfundon ndikimi i shariatit dhe ai bëhet krejtësisht i papërdorshëm dhe pavlerë.

Domethënia e qartë e këtij dallimi përfshin të dhënat që sufijtë e hershëm kurrë nuk janë konsideruar krejtësisht të lirë nga lidhja me shariat-in, ata kurrë nuk kanë marr guximin që për vete të kërkojnë të drejtë, siç e bënin keramitet dhe të tjerët, të jenë ligj për vete, ose ligjdhënës për të tjerët.

Pos këtyre dallimeve në mes qëndrimit të sufijve, nga njëra anë, dhe teologëve, keramit dhe të tjerëve, nga ana tjetër, sufiu i hershëm ka pasur nevojë edhe për një dallim, e ky është dallimi midis qëndrimit ndaj shariatit dhe ndaj myslimanit të zakonshëm. Ai mendon se, gjersa njeriut të zakonshëm religjioz i lejohet shumë lloje të lehtësimeve dhe koncesioneve në kuadër të shariatit, të tilla lehtësime dhe koncesione për sufiun nuk ka.

Ai nuk ka qëllim ta kursej veten në të përm-bajturit e rregullave dhe udhëzimeve të shariatit. Për te nuk ka “ia bëjmë disi” në shariat: sufiu i hershëm ka besuar në një shkallë tejet të lartë të harmonizimit me Ligjin. Për sufiun nuk ka delikt dhe pushim: nëse ky pushim i lejohet të tjerëve, atij i ndalohej.

Ky qëndrim i ashpër i sufiut nuk është rezultat i besimit të tij në asketizëm por kjo para së gjithash është rezultat logjik i qëndrimit të tij bazë ndaj Zotit i cili është qëndrim themelor dhe përmes virtytit të cilit ai ka të drejtë të quhet sufi. Lehtësimet të cilat ia mundëson shariat mysliamanit të zakonshëm janë përcaktuar me pozitën e tij në jetë aq sa i pranon të drejtat dhe obligimet të cilat ia parashtrajnë ose caktojnë grupet e ndryshme në të cilat hyn vullnetarisht. Për sufiun nuk ka anim të tillë ndaj ndonjë grup shoqëror, andaj ai nuk mund të kërkojë të drejta dhe obligime speciale për përmëshjen e cilave do të ishin të pakalueshme lehtësimet dhe koncesionet brenda shariatit. Ky qëndrim bëhet i qartë nëse krahasohet qëndrimi i sufiut me qëndrimin e asketit: gjersa asketi beson në strategjinë e flijimit të sotëm të këtij fitimi ose pasurie, në kërkimin e së mirës sufiu beson në urdhrin e plotë që duhet arritur Zotin. Asgjë nuk është aq e vlershme, e çmueshme apo delikate e që të mos jetë i inkadruar në përpjekjen e sufiut që ta arrijë burimin i cili mund t’ia shuaj etjen.



“ Në përvjetorin e ngritjes

# Kontribut i baba Sh

**T**eqeja e Panaritit ndodhet në një pozicion gjeografik të rëndësishëm të kësaj zone malore, si e tillë ajo kufizohet me Tepelenën, Përmetin, Beratit në afërsi të rrugës automobilistike, Këlcyrë-Berat. Panariti ndodhet i vendosur në të dyja anët e një lugine që fillon në Qafën e Këçokut dhe vazhdon deri sa lumi bashkohet me lumin Osum, në Poliçan të Skraparit. Gumanit është lagje e Panaritit, dhe ka qënë dikur në juridiksionin administrativ të Beratit dhe varej nga teqeja e Prishtës. Kurse sot është në juridiksionin e bashkisë Poliçanit me ligjin e ri të ndrajes administrative teritoriale të vitit 2014. Qysh herët është ngritur këtu teqeja e Panaritit ndaj shpeshherë banorët i thonë teqeja e Gumanit. Ajo ka afër teqenë e Lavdarit, Bubësit të Sipërm (Zaimallarë) dhe Prishtës. Nga burime historike dhe gojore del se themelimi i saj daton në vitin 1902 nga baba Hyseni, i fshatit Panarit, Ai u rrit dhe u mëkua nga prindërit e tij me dashurinë ndaj Zotit dhe atdheut. Ata e çonin që në fëmëni në ceremonit të ndryshme fetare në teqenë e Therepelit dhe të Prishtës Në moshën madhore me dëshirën e zjarrtë për t’i shërbyer bektashizmit mori dorë te baba Beluli i teqesë Therepelit. Këtu u njohë nga afër me detyrat fetare ceremonitë. U bë myhib dhe kandidat për dervish duke zbatuar kodin bektashian. Në teqenë e Therepelit shërbeu disa vite. Më pas baba Beluli, e dërgoi edhe në Haxhi Bektash-Turqi ku mori një kulturë të gjërë fetare për dy vjet. Përsëri u kthye nga Turqia dhe shërbeu deri në vitin 1902 në teqenë e Therepelit. Me dëshirën e tij dhe të kërkesës të fshatit Panarit nën kujdesin e baba Belulit, në lagjen Guman ngriti teqenë me ndihmën e banorëve të fshatit dhe besimtarëve të zonës. Ai shërbeu për një periudhë kohe në këtë teqe, i cili la gjurmë te gjithë besimtarët dhe rrezatonte dashuri, urtësi dhe vëllazëri. Në këtë teqe edukoi me njohurit bektashiane nipin e tij Shahinin, i cili më vonë u bë një baba i njohur në gjithë zonën. Në vitin 1910, la të shërbente në teqenë e Panaritit nipin e tij, kandidat për dervish, Shahinin.

Nevojat e kohës në vitet para shpalljes së pavarësisë baba Hyseni ndodhet në teqen e Rabijes të Tepelenës dhe mbante lidhje me baba Ismailin e Gllavës, baba Medin Gllava, baba Ahmet Turani i Tepelenës, baba Ahmet Koshani. Ai u mor edhe me veprimtari patriotike për çështjen kombëtare sidomos në



# së teqesë së Panaritit //

# ti i çmuar ahinit

Për këtë flet edhe kënga e popullit:

Në Therepel veshe harkanë,  
Në Guman ngrite dergjan  
O baba , o pëllumb i shkruar,  
Nga Panariti ke dale.

*Të morën baba të morën,  
Dëshnica me Skrapar,  
Shpejtove baba shpejtove  
Në Prishtë vajte qëndrove.*

Këtë teqe të njohur në gjithë malësinë e Tepelenës, Beratit dhe Skraparit e drejtoi deri në vitin 1965, baba Shahini, i cili ka një histori interesante. Po kush është baba Shahin Guman?

Ka lindur në fshatin Bubës të rrethit Përmet, në lagjen Mihaj më 9 tetor të vitit 1886. Prindërit e tij ishin: babai Alizoti, nëna Zulka, ishte bijë nga Komari i Tepelenës. Në biografinë e tij që e ka lënë me shkrim në vitin 1952, ai shkruan: "Baban tim nuk e mbaj mend fare mbasi më ka lënë të vogël, kështu që nuk më ka lënë as pasuri as të ardhura. Unë kam jetuar si punëtor krahu dhe më pas jam marrë me punë fetare. Prej vitit 1896 deri në vitin 1909 jam marrë me punë krahu si punëtor. Prej vitit



ndihmesën për çështjen e Pavarësisë në vitet 1911-1912. E më pas shkoi në teqenë e famshme të Prishtës me kërkesën e besimtarëve të Dëshnicës dhe Skraparit, të cilën e drejtoi deri në vitin 1922, kur ndërroi jetë. Baba Hyseni ndihmoi në çështjen e gjuhës shqipe, për pavarësinë e Shqipërisë, përgatitjen e dervishve, që kjo teqe kish kohë që organizonte shkollë për kulturën fetare. Në dokumentat arkivore shkruhet se është ndër të parët baba që merret për organizimin e kongresit bektashian të Prishtës më baba Kamberin, baba Ali Tomorrit dhe citohet në disa dokumente arkivore për kërkesën me baballarët e tjerë në një letër dërguar qeverisë së Sulejman Delvinës që të bëhet kongresi në teqenë e Prishtës të Skraparit, janar të vitit 1921..

1910-1913 kam shërbyer në teqen bektashiane të Gumanit si kandidat për dervish. Në vitin 1914 kam shërbyer si dervish në këtë teqe. Me kërkesën dhe pëlqimin tim jam veshur dervish në vitin 1914 në teqen e Gumanit Berat. Jam graduar baba më 1921 me propozim të popullit dhe me vendim të baba Ahmet Turanit. Në vitin 1947 jam arrestuar nga forcat e sigurimit të shtetit për arsye politike. Jam gjykuar e dënuar tre vjet në burgun e Gjirokastrës dhe në vitin 1949 jam liruar duke m'u falur një vit".

Për vitet që pasuan, shërbeu në shumë teqe të vendit. Në vitin 1917-1918 ka shërbyer si dervish në teqen e Melçanit të Korçës. Në këtë teqe ka takuar dhe u ka shërbyer, patriotëve Sali Butka e Themistokli Gërmenji.



Në këtë periudhë ka qënë në shtëpinë e Ymer Dishnicës, një doktor i njohur. Ymeri kishte xhaxha baba Hysenin e Melçanit, i cili ka kaluar nga jeta në teqenë e Shëmbërdhenjit. Në një ditë dimri ndodhej në shtëpinë e Ymer Dëshnicës. Ra shumë dëborë. Teqeja e Melçanit kishte 150 kokë dhën. Ishte Lufta e Parë Botërore një gjendje kaotike dhe plot varfëri. Teqeja ishte pesë orë larg nga fshati ku ndodhej dervish Shahini. Kur pa këtë mot të vështirë bore i tha të zotit të shtëpisë: "Do shkoj në teqe, t'iu shërbej dhënve, se janë pa ushqim. Mos ik mor bir! -tha i zoti shtëpisë, se është luftë. Por ai vendosi dhe iku. Në kthim, në një kodër e kapën ushtarët francezë dhe e arrestuan. Kur hynë në qytetin e Korçës, pa sekretarin e Themistokliut. I thirri: - "Jam dervish Shahini! - lajmëro Themistokliun se më kanë arrestuar". Themistokliu ndërhyri te francezët dhe ata e lanë të lirë.

Teqeja e Melçanit ishte bazë e çetave të lirisë, në rilidjen kombëtare por edhe në këtë periudhë të vështirë. Dervish Shahini shërbente në teqen e Melçanit në Korçë dhe kryente çdo detyrë që e ngarkonte babai. Është koha kur baba Shahini shërbente si dervish në teqen e Melçanit në Korçë, këtu mori një përvojë të mirë, jo vetëm si klerik por dhe patriotizmin ndaj atdheut. Më pas erdhi në Panarit dhe vazhdoi punën në drejtimin e teqesë. Gjatë gjithë jetës së këtij kleriku, cilësia më vezulluese, më mbresëlënëse, më frymëzuese për masën e njerëzve, besimtarë dhe jobesimtarë, ka qënë puna e tij. Ishte një punëtor i pa shembullt. Punët që ai bënte rrezatonin art, pavarësisht nëse punonte tokën, nëse i shërbente bagëtisë, nëse verseliste pemët, gjithshka që ai bënte në përfundim, ishte art. Në vitin 1921 u gradua baba nga Ahmet Turani i Tepelenës në teqenë e Gumanit. Ishte puntor dhe organizator, teqenë e lartësoi, me pasuri dhe dha një ndihmesë në shërimin e sëmundjeve dhe qeramete. Baba Shahini e zbatoi porosinë e baba Hysenin për ta rregulluar dhe zbukuruar teqenë e Gumanit. Me punën e tij të palodhur, me mbështetjen dhe plotë dashuri të besimtarëve e transformoi teqenë, në një oaz të vërtetë paqeje dhe qetësie. Disiplina, edukata e punës, përkushtimi dhe respekti ndaj besimtarëve, ishin cilësi që ndikonte dhe udhëzonte tek çdo njeri që jetonte pranë tij.

Lumi ishte një problem i vërtetë për njerëzit që për arsye të ndryshme duhet të kalonin nga njëra anë e lumit në anën tjetër, në dimrin e acartë. Kur binte shi lumi fryhej furishëm dhe ishte shumë i rrezikshëm. Babai, në një vend shumë të përzgjedhur me kujdes ndërtoi një urë prej guri, që ishte një gjysëm rreth në të dy anët e lumit. Në urë kalonin edhe kafshët. Kjo urë është ndërtuar midis viteve 1925-1930. Për më shumë se 50 vjet i shërbeu njerëzve në jetën e tyre të përditëshme, miqëve dhe udhëtarëve që vinin në ato zona. "Kaluam tek ura e baba Shahinit", "pushuam tek ura e baba Shahinit", "ishim tek ura e baba Shahinit", kanë qënë pjesë e bisedave të përditëshme. Por fatkeqësisht, në fillim të viteve 1990 ura u shkatërrua nga erozioni dhe moskujdesja. Ndërsa për baba Shahinin mund të thuhet pa e tepruar, se ishte një klerik që ndërtonte vepra të tilla bamirëse. Ndërtoi mullirin dhe çezmën që njihet me këtë emër. Verseliti arat me vreshta rrushi që njihen me emrin "arat e babait". Njerëzit që kanë përjetuar përkushtimin me të cilin ju drejtohej dhe i respektonte, që kanë shijuar bukuritë e punëve që ai realizonte, e kujtojnë me nostalgji dhe admirim të veçantë. Ja si janë shprehur, besimtarët dhe banorët e zonës përreth: "Ka qënë baba i mire, i vërtetë, i pastër, mikpritës, bënte qeramete, ndërtimtar, shembull për të gjithë, punote vetë, atdhetar". Ujin që vinte në teqe e mori mbi një kilometër larg. Hapi në mal një kanal të thellë rreth një kilometër të gjat, të shtruar me dërrasa guri poshtë dhe anash, me llagëm në traditën e ndërtimeve, që solli ujin pranë teqesë. Rreth viteve 1930 në një pozicion të

përshtatshëm buzë luginës afër urës ndërtoi një mulli me ujë. Mulliri punonte natën dhe ditën, pa pushim. Më 4 prill 1934 lindi nipi tij. Ai tregonte: Isha në mulli kur më dhanë sihariqin, po lexoja librin e Skënderbeut. Tek faja që lexoja shkrova: 4 prill 1934. Muhamed do ta ketë emrin. Baba Shahini punonte kudo, në mulli, në arë dhe kudo ku kishte nevojë. E fillonte punën vet i pari dhe pastaj besimtarët dhe njerëzit e afërm e ndihmonin. Pranë mullirit, nën hijen e një arre të madhe, ndërtoi një çezëm. Ujin e mori nga dhjetra metra larg në pyll. Shprehjet, shplohemi tek çezma e babait, do pijmë ujë tek çezma e babait, janë pjesë e bisedave të njerëzve që jeta dhe puna i lidh në ato vende.

Në vitin 1947 e arrestuan. Regjimi komunist nuk e kishte të vështirë të ngrinte akuza. E çuan të lidhur në burgun e Gjirokastrës. Si i burgosur ka punuar në kanalet e fushave. Punonte shumë dhe sillej mirë. Eprorët e burgut e respektonin. Mbas dy vjetësh e liruan duke e nxjerrë të pafajshëm për akuzat që i bënë. Edhe mbas burgut drejtoi teqenë e Gumanit. Babai ka ndihmuar njerëzit, kur ata i kanë kërkuar ndihmën e tij. Njerëzit tregojnë disa raste nga Panariti. U sëmurë nga koka me dhimbje të padurueshme. Katër ditë i dukej sikur ia tërhiqnin kokën me litar sikur e mbysnin, të afërmit i rrinin pranë dhe i qëronin kungull dhe ia vinin mbi kokë. U thoshë të më bëni duha tek baba Shahini. Nuk lejohet i thoshin. Ishte koha kur ishte i nda-





luar besimi tek feja, mbas vitit 1967. Nipi këmbënguli të vinin te baba Shahini. Dërguan një pagur raki dhe njëqind lek. Sapo nipi kish trokitur në derë të babait, dhjetra kilometra larg dhimbjet pushuan dhe më pasë erdhi duhaja.” Një grua e moshuar nga një fshat fqinj, kishte krushkun e saj shumë të sëmurë, sidomos ishte agresiv. Ja si tregon ajo: “Vajta tek baba Shahini. I çova këmbëshën e krushkut. Babai po bënte një qipi (mullar) me dushk. Zbriti më takoi. Pastaj thirri nipin e tij, i cili ishte afër shtëpisë me punën e tij, dhe i tha: si t’ia bëjë. Ishte problemi i sigurimit dhe s’donte t’ju sillte telashe njerëzve të familjes. Nipi i tha: “Baba njerëzit kanë halle, ndihmoje.” Ky pasi bëri lutjet e rastit, i tha gruassë moshuar, ik tani. Kur të vesh në shtëpi do ta gësh të qetë dhe kështu ndodhi.

Ja si tregon nipi i tij Muhameti: Nuk e kisha pyetur kurrë. Një ditë të bukur me diell ishim të dy jashtë, në oborr në këmbë. I thashë: “baba si ja bënë, ku e gjen forcën?” U mendua gjatë dhe më tha: “Po ja Muhamet, unë nuk bëjë gjë vetë. Vetëm i lutem atij lart, Zotit.” Niprit e baba Shahinit tregojnë: Dede Ahmeti ka ndenjur dy ditë në teqen e Gumanit. Njëherë tregonë një histori baba Shahinit: “Një zotëri që nuk donte të vdiste i hipi kalit, të cilin e quanin Durra, e u tha njerzëve që e rrethonin: Do shkoj në një vend ku nuk ka vdekje. Ec e ec e pyeste: Ka ndonjë vend ku nuk ka vdekje? I thanë këtu nuk ka. Ai tha: “Prit

Durra, se këtu vdekje s’ka.” I zbriti kalit dhe u rehatua i lumtur. Njerëzit e atij vendi i thanë: “Vërtet këtu vdekje nuk ka, po atje tek mali është një që e quajnë Kolë. Kola del në akshëm ditë për ditë e thërret: Hajde lart, hajde lart. E ata që venë nuk kthehen më. Kështu ndodhi dhe Kola e thirri: Hajde lartë. Durra vajti dhe nuk u kthye më.” Historia tjetër që ka treguar Dede Ahmeti është: “Kaposhi këndonte. U afrua dhelpra, kaposhi i tha: “Po ti?: Demokraci, tha dhelpra. Kaposhi u ngrit lart në pemë. “Pse u ngrite? i tha dhelpra?” Demokraci i tha kaposhi. Erdhën gjahtarët. Dhelpra iku. “Pse ike?” i tha kaposhi, është demokraci? E po demokraci, në ca e dijnë e ca s’e dijnë, tha dhelpra.”

Në vitin 1965 u caktu të drejtonte teqenë Rabijes në rrethin e Tepelenës. Ishte koha kur regjimi komunist dhe sigurimi i shtetit përdornin lloj-lloj mënyrash për t’i mërzhitur shërbëtorët e Zotit, për t’i ndarë ata nga gjëja më e shtrenjtë që kishin, besimi. Teqeja në Rabije u prish nga vandalët e kohës. Kjo i shkaktoi baba Shahinit një dhimbje shumë të madhe. Në vitin 1967 u kthye nga Rabija, në familjen e tij në Gumaj. Familja ku ai jetoi, ka qënë një model i rregullit, pastërtisë, mikpritjes, përkushtimit ndaj punës. Babai me shembullin e tij u paraprinte këtyre vlerave dhe i frymëzonte tek pjestarët e tjerë të familjes. Punonte vazhdimisht. Ndhimonte në punët e familjes dhe të kooperativës. Kishte një dhomë të tijën, në të cilën rrinte. Nga të gjithë edhe sot ajo thirret me emrin “dhoma e babait”. Në dhomë kishte të vendosur në krevatin, një sepete. Sa herë hynin fëmij në dhomë, hapte sepeten dhe i jepte diçka për të ngrënë. Kur nusja e shtëpisë, Bukurija, i binte ushqimin e vaktit ai e pyeste: “Hëngrën fëmijët? Shiko ata, mos na shiko ne pleqve, se nuk na gjen gjë”. Në krye të dhomës, përball derës, ishte oxhaku. Në dimër në atë oxhak gjithmon kish zjarr që digjej mes psherëtimave të klerikut. Babai kujdesej shumë për zjarrin. Besoj se e vlerësonte si dhuratën më të madhe që i ka falur Zoti njeriut. Gjatë stinës së verës dhe vjeshtës grumbullonte drutë nga pylli me lisa, drutë i priste vet dhe i mbante në krah. Përball dritares së dhomës bënte stivat me dru shumë të trasha, që i quanin kërcëpa. Në fillim të dimrit gjithmon aty ishin të rreshtuara dy stiva të gjata me kërcëpa. Digite stivën e bërë një vit më par dhe stivën tjetër e linte të thahej që ta digte vitin tjetër. Nuk linte njeri që t’i mernin drutë pa lejen e tij. Rrinte në qoshen e djathtë të oxhakut i ulur këmbëkryq në një lëkur dashi duke vështruar vazhdimisht zjarrin. Një orë e vogël ishte e varur në mur mbi kokën e krevatit ku flinte. Sa hapje derën e dhomës dëgjoje melodinë e pastër dhe të ëmbël të tiktakut të saj. Ajo ishte melodia që prodhonte meditimi i thellë dhe heshtja e shenjtë e asaj dhome. Në vitin 1985 në moshën 95 vjeçare, u sëmurë dhe për 15 ditë luftoi me vdekjen në shtratin e tij. Në njërën prej këtyre ditëve nipi e pyeti: “Baba ke frikë nga vdekja?” “Jo bir i tha, asnjë çik, duke tundur gishtin tregues”. Por e porositi se si duhet të vepronte pas vdekjes së tij në mënyrë që ceremonia mortore të ishte sa më dinjitoze. Ai kishte një punëtor dhe shërbyes, ndihmës të teqesë nga viti 1936 deri në vitin 1960. Teqenë e Panaritit e rrafshuan në vitin 1967 me ndalimin e fesë. Mbas viteve 1990 besimtarët i ngritën tyrben baba Shahinit dhe aty shërbejnë niprit dhe mbesat e tij. Baba Shahini do përkujtohet me dashuri për veprën e tij nga banorët e fshatit dhe zonës Beratit, Tepelenës dhe Skraparit.

**Nuri Çuni**

*Burimet:*

AQSH, F. 490 v. 1952 D. 1452 fl. 69.

AQSH, F. 490 v. 1952 D. 1452, fl. 67.

Kler, Natalie: *Shqipëria vendi i dervishëve, Paris, 1990, f.352*

Hasluck F.É., 1929/a: f. 544.

Babinger: *Harta e Shqipërisë, viti 1962*

## Tyrbe e baba Shahinit





# Visare nga dituria e Imam Aliut



***Të nderuar lexues të "Urtësisë"!***

***Ciklin e shkrimeve me visare të urtësisë, diturisë dhe largpamësisë të Imam Aliut, paqja qoftë mbi të, po e nisim në këtë numër të revistës sonë. Vullneti dhe etja, që klerikët, myhibët, apo dashamirësit e udhës së Haxhi Bektash Veliut kanë rrëfyer për këto dituri, ka qënë e hershme. E hershme ka qënë ndërkaq edhe vemendja e prijësve bektashianë, për të përcjellë këtë univërs dituror nëpër breza. Ka qënë pikërisht dede Ahmet Myftari, i cili në fillimet e viteve 50-të të shekullit të kaluar udhëhoqi një grup studuesish dhe përkthyesish të talentuar, duke sjellë në gjuhën shqipe kryevepra të literaturës bektashiane njëjën pre së cilës "Divani Ali" po e shfletojmë sot, me bindjen e thellë se do të na ndihmojë të gjithëve në udhëtimin tonë shpirtëror.***

***Redaksia***

**N**ë kohën e hilafetit të Osmanit të birit të Affanit, nga fisi i Emevive, ai emëroi nëpër pozitat e larta, njerëz nga fisi i tij, sidomos krye-sekretarin Mervanin që e kishte kiushëri të parë. Të gjithë këta ishin njerëz kriminel e të stërvitur me krime dhe me veprat e tyre keqbërëse. Të gjithë popullin e çuan në greminë, sidomos valiu i Egjiptit, i quajtur i Ebu-Surh u provua si njeri tiran i madh, duke zhdukur e torturuar, plaçkitur të gjithë tarafin e Ehli-Bejtit, kudo që i gjente. Kështu që keq-sjelljet e tij tiranike në Egjipt arritën kulmin, dhe për këtë shkak populli i atjeshëm dërgonte herë pas herë njerëz për ankime në Medinë, dhe bile njëri prej tyre u vra, pafajësisht në atë qytet prej tarafit të Ememive.

Pas kësaj ndodhie, 700 vetë nga populli i Egjiptit u nisën an-grup për në Medinë për të parashtruar ankimet e tyre. Këta ju paraqitën Hazreti Imam Aliut, Aishes, Telhajt e Zyberit, të cilët duke marrë vesh këto informata, ju drejtuan Osmanit, dhe mbasi ia parashtruan të gjitha, i kërkuan transferimin e guvernatorit të përmendur prej andej, mirëpo Osmani u tha se nuk kishte dijeni mbi këto padrejtësira dhe ju premtoi për të dërguar si guvernator në Egjipt atë që tju pëlqejë këtyre, të cilët propozuan Muhamedin, të birin e Ebu-Beqirit që ishte njeri i drejtë dhe i mirë, i njohur gjithkund, i cili u thërrit dhe ju dha urdhër që të nisët për në Egjipt, për ti dërguar dekretin më vonë sipas zakonit; mirëpo ky mbasi u nis, prapa u dërgua një djalë i ri me dekretin



përkatës, i cili u nis me një deve pas tij, dhe duke e ngarë devenë me vrap, Muhamedin e zuri në udhëtim e sipër. Ky u bashkua me djalin, dhe kur ranë për të fjetur, Muhamedin nuk e zuri gjumi, e këndoi dekretin, ku në vend që të thuhej ‘ta pranoni si guvernator’, ishte shënuar fjala ‘ta vritni’. Ky mbasi e pa këtë, u kthye prapë bashkë me djalin për në Medine, dhe u paraqit drejt te Hazreti Imam Aliu, të cilit ia tregoi dekretin, duke u ankuar për këtë padrejtësi që i bëhej. Mbi këtë Imam Aliu, mori me vete Aishen, Telhan, Sadin, Zyberin dhe Muhamedin bashkë me dekretin dhe shkuan te Osmani, duke e pyetur nëse kishte dijeni për këtë mashtrim.



Por Osmani u betua para të gjithëve se shkrimi që përmban dekreti nuk ishte i tij. As që kishte dijeni mbi përmbajtjen e dekretit; atëhere i gjithë faji iu ngarkua krye-sekretarit, Mervanit e të pranishmit u shpërndanë. Mbasi u kthyen nëpër viset e tyre, këto ngjarje u përhapën gojë pas goje derisa arritën në Egjipt, në Qofe e gjetkë, ku u bë një bujë e madhe. Popullata e Egjiptit, e Qofes, e Basrës dhe shumë viseve të tjera të impresionuar nga përshtypja e keqe e këtyre lajmeve u mblodhën dhe sulmuan qytetin e Medines, duke rrethuar pallatin e Osmanit për 46 ditë rresht. Sado që Imam Aliu shkoi dhe i këshilloi dhe bile për mbrojtjen e jetës së personit të Osmanit la si roje djalin e tij, Imam Hasanin, e shumë të tjerë, por rrethuesit në anën tjetër e thyen shtëpinë dhe vranë Osmanin me disa shokë të tjerë.

Kjo ka ngjarë më datën në vitin 35 të hixhretit, ku ndër këto u plagos dhe Imam Hasani që bënte detyrën e rojes. Mbas kësaj ngjarje u mblodh një shumicë e popullit nga të gjitha viset e Arabisë, duke pasur si prijës Telhan dhe Zyberin, dhe shkuan te Hazreti Aliu duke ia ngarkuar hilafetin me dashje e padashje. Imam Aliu pasi e mori përsipër këtë barrë, puna e parë që bëri ishte të shkarkojë nga puna të gjithë ata që ishin prej fisit të Osmanit dhe që me veprat e tyre të liga e kishin çuar popullin në greminë. Në anën tjetër Mervani, i cili në rrethimin e sipërmori një plagë të rëndë dhe jeta e tij u shpëtua nga Imam Hasani. Ky mori me vete këmishën e Osmanit të lyer me gjak dhe shkoi në shtëpinë e Aishes, të shoqes së Profetit tonë Hazreti Muhamedit, të cilën e kurdisi se gjoja vrasja e Osmanit është kryer me shtytjen e Hazreti Aliut.

Imam Aliu e pushoi nga puna Mavijen që ishte guvernator në Sham dhe në vendin e tij dërgoi Sehlin, të birin e Hanefiut. Mavija me të marrë vesh këtë, revoltoi e u arratis bashkë me Mervanin e me shumë shokë të tjerë, duke i dërguar fjalë Imam Aliut për dorëzimin e kriminelëve të Osmanit, meqë si kushëri që e kishte, gjaku i takonte këtij. Por Hazreti Aliu iu përgjigj se: Ai nuk mund ta plotësonte këtë kërkesë, mbasi në vendin e ngjarjes ka qenë një shumicë e madhe populli, dhe ndër këta nuk ka pasur si të

dalloheshin vrasësit. Atëhere, këta me të marrë vesh këtë përgjigje prej Imamit, e bindën turmën se shkaktar i vrasjes së Osmanit ishte Imami vetë. Po kështu, kurdisën Aishen, Talhan, Zyberin dhe shumë të tjerë dhe gjithë së bashku morën drejtimin për në Basra. Kur në udhëtim e sipër, duke iu afruar Basrës, në buzë të lumit Hev-Eli iu turrën qentë e katundit Aishes dhe i lehën, asaj në këtë moment iu kujtuan fjalët e të shoqit të saj, Profetit Hazreti Muhamed, që kishte dëgjuar nga goja e tij se: “Një nga gratë e mia do të luftojë kundër Aliut, kurse Aliu është me të drejtën dhe gruaja ime me të shtrembrën, dhe ajo kur të arrijë në vendin Hev-Eli do t’i lehin qentë. Vallë të mos jesh ti Aishe

që do të kundërshtosh Aliun?” Këtu në këtë vend menjëherë, Aisheja, si i erdhi ndër mend fjala e sipërme, u pendua, dhe mbasi ua tregoj çështjen, Talhajt e Zyberit dhe të tjerëve nga paria, iu shfaqti dëshirën për tu kthyer prapë. Por Zyberi i tha se nuk është e pëlqyer për tu kthyer, mbasi do të dalim me trup, kemi shpresë që inshallah çështja të zgjidhet paqësisht, dhe kthehemi të gjithë me një herë; dhe kështu shkuan në Basër ku rrëzuan Hazreti Imam Aliu dhe morën sundimin e qytetit të vet në dorë.

Imam Aliu sapo i mësoi këto lajme, e urdhëroi të birin Imam Hasanin dhe Amarin të birin e Josirit që të shkojnë në Qofe për të përgatitur 10 000 ushtarë, duke i thënë se do të vinte edhe vetë për të shojtur komplotin që ish kurdisur në Basra; kjo ngjau në vitin 36 të hixhretit. Imami e mësyri me atë ushtri, në një distancë prej pesë kilometrash afër Basrës, në vendin e quajtur “Xhel ha” u përpoqën të dy ushtritë dhe pas shumë bisedimesh që patën nuk mbetën dakord, e nisi luftën ana kundërshtare në dt. 20 e njëte në vitin 36 të hixhretit; këtu u zhvillua një luftë e shkurtër, por e rreptë. Në luftë e sipër Imami Aliu duke thirrur me zë të lartë, thirri Zyberin dhe i tha që të pushoj luftën për një moment, mbasi kemi edhe dy fjalë për të thënë; dhe në qofsh burrë eja pranë meje të fjalosemi. Mbi këtë thirrje lufta pushoi, dhe Zyberi iu afrua Imamit, i cili e pyeti: atë kujtohen fjalët e Profetit tonë Muhamedit a.s kur neve një ditë ishim duke biseduar së bashku me buzë në gaz si shokë të ngushtë që ishim, e të tha se do të vij një ditë që ti do të luftosh kundra Aliut; kurse e drejta është e Aliut, dhe nis nuk pendohesh do të quhesh keqbërës. Zyberi i tha Imam Aliut: M’i përsërit edhe një herë këto fjalë, dhe porsa Hazreti Aliu ja përsëriti, atëhere Zyberi tha se po më kujtohet, dhe e quaj vehten të gabuar; duke i kërkuar ndjesë. Pas bashkë fjalimit që pati Zyberi me Imam Aliun, u kthye pranë shokëve të tij dhe ua tregoj çështjen dhe u nis për në Medine.

Kur ku ishte duke udhëtuar, Ameri i biri Xhermuzit që ishte nga ushtria e Imamit, pa marrë asnjë urdhër prej Imamit, i prapa Zyberit, dhe e zuri në vendin e quajtur: “Vades Zuba”, në befasi

i ra me shpatë dhe e vrau; mandej i mori shpatën dhe ja solli Imamit, duke i thënë, se kjo është shpata e Zyberit të cilin e vrau, me shpresë që të merrte ndonjë shpërblim nga Imami. Mirëpo Hazreti Aliu u dëshpërua tepër nga ky lajm ju dhimbs shumë Zyberi, dhe iu kthye kriminelit me zemërim, duke i thënë “Kush vret Zyberin, bën pjesë nga ata që do të hyjnë në skëterrë”. Dhe shpatën e Zyberit që ja dorëzoi Amiri, ja nguli në bark dhe e vrau. Në kohën kur u kthye Zyberi, i hyri grindje Telhajt me Mervanin, të cilët kishin pasur armiqësi të vjetër në mes të tyre, dhe Mervani e vrau Telhan. Ndër kaq u ndez lufta përsëri, dhe Muhammedi i biri Telhajt u vra në këtë luftë.

Siç thamë më sipër, Aisheja, bënte pjesë dhe ajo në këtë luftë, hipur mbi deve; dhe fisi i Beni Dabes ja mbanin frerin e deve, duke e pasur në këtë nën mbrojtje dhe duke e respektuar si bashkëshorten e Profetit që ishte, për të mos rënë në dorën e armikut, dhe frerin nuk ja lëshonin prej dore, deri sa shtatëdhjetë vjet u prenë duart ushtarët e Hazreti Aliut, dhe kështu ia treguan çështjen Hazreti Aliut, Ky urdhëroi të vëllanë e Aishesë që ta ruante vetë si motër që e kishte që të mos e prekte tjetër njeri përveç dorës së tija. Por sa u kap Aisheja nga i vëllai, lufta u pre; dhe kësaj lufte i mbeti emri: “Lufta e Devesë”. Në këtë rast u vranë shumë njerëz dhe Imami e priti Aishen me nderime, jo si rob lufte, duke i thënë se: “A e kuptove gabimin që bëre Aishe, Zoti të fal!” kështu, Imami hyri në Basra ku qëndroi 15 ditë dhe la si guvernator kushëririn e tij Abdullahun të birin e Abazit, e mbasi u stabilizua qetësia në vend, ai vetë u kthye për në Qofe.

Përveç kësaj kemi dhe luftën e Sifinit, ku në këtë luftë janë vrarë shumë nga dashamirët e Ehli-Bejtit; sidomos ndër-mjet të cilëve dallohen: “Ammar Jasiri, Hashim Atabeja, Abdullah Bedili, Vejsel Karanija etj etj. Përsa flet Imami mbi këto dredhira, do të japim disa shpjegime kur t’u vijë rradha.

Është një nga turpërimet e Ehli-Bejtit dhe tradhtia e 60.000 ushtarëve që bënë pjesë në ushtrinë e Imamit, të cilët mbasi u tërhoqën nga skema e luftës, u mblodhën në vendin e quajtur “Harura” afër Qofes dhe këtu përgojuan Imamin tonë.

Pastaj Hazreti Aliu në luftën e Nehrivanit i shpartalloi këta. Një dhunim tjetër që i është bërë Ehli-Bejtit është dhe helmimi i Maliq Eshterit nga njerëzit e Mavijes; kur ky ishte duke i shkuar në ndihmë guvernatorit të Egjiptit, Muhammedit të birit të Ebu-Beqirit; mbi kërkesën që ik bëri Imami i dërgoi Maliqin, mirëpo ky në udhëtim e sipër u helmua nga njerëzit e Mavijes. Mavija pasi mori në dorë push-tetin në Sham, nisi Amrin të birin e Asit me gjashtë mijë ushtarë në Egjipt, të cilin e kishte një besnik më të ngushtë; Amri në luftën që bëri në Egjipt me Muhammedin, të birin e Ebu-Beqirit që ishte guvernator i Egjiptit, e mundi këtë dhe e vrau, edhe vetë u bë guvernator i tij vendi.

Në vitin 40 të hixhretit u mblodhën të gjithë harixhit në një vend dhe i shpallën popullit se: shkaktarët kryesorë të kësaj ngatërrese ishin tre veta: Imam Aliu, Mavija dhe Amri, dhe po të vriteshin këta atëherë kishte për tu shuar ky fesat. Për këtë qëllim kërkuan tre vullnetarë nga turma, dhe vrasjen e Imamit e mori përsipër Abdurrahman Mylxhemi; të Mavijes, Haxhaxhi, i biri i Abdullah Dasiriut dhe të Amrit, Daruja, i biri i Anterit, të cilët vendosën që të nisen që të tre përnjëherë, e komploti të bëhet në një ditë, e cila ishte e 17-ta ditë e Ramazanit. Kështu që Abdurrahman Mylxhemi bleu një shpatë për një mijë florinj, të cilën e helmatisi dhe shkoi në Qofe. Ku në mëngjesin e të 17-tës ditë të Ramazanit, kur Hazreti Shahu ishte duke falur sabahun në Xhaminë e Qofes, e goditi me shpatë në kokë Imamin dhe e plagosi rëndë, i cili pas tri ditëve ndërroi jetë. Gjithashtu dhe Haxhaxhi, po atë ditë shkoi në Sham, dhe e plagosi me shpatë në kokë Mavijen, por meqënëse plaga që mori Mavija ishte e lehtë, ky shpëtoi. Po kështu veprooi dhe Daruja, shkoi në Egjipt në të njëjtën ditë, por meqënëse nuk e njihte personalisht Amrin, shkoi në xhami ku falesh sabahu, e duke kujtuar se sipas zakonit Imam do të ishte Amri, si guvernator i ra atij të kryesonte faljen, mirëpo meqënëse Amri atë ditë nuk doli vetë në xhami, por kishte deleguar një tjetër, dhe në vend të Amërit, u vra i deleguari, i quajtur “Harixhi”.

Në kategorinë e dhunimeve që i janë bërë Ehli-Bejtit, hyn dhe ngjarja e vajtueshme e Qerbelasë, në fillim të vitit

61 të hixhretit, ku t të dhjetën ditë të Muharremit është bërë dëshmor Imam Hysejni me 72 veta, nga ushtri e Jezitit. Po kështu dhe 9 imamë të tjerë që rrjedhin nga brezi i Imam Hysejnit janë helmuar e janë bërë dëshmorë prej kundërshtarëve të Ehli-Bejtit. Nga të 12 Imamët, 5 janë persekutuar e bërë dëshmorë prej emevive dhe shtat prej abasive.


Tani le t ndalemi tek disa filozofi t shklqyera t Imamit ton.

“Njerëzia, nga pikëpamja e formës është e njëjtë, sepse që të gjithë kanë për baba “Ademin” dhe mëmë “Havanë”.

*Sqarim: Siç dihet që Ademi është e para krijesë e racës njerëzore, të cilin Zoti e gatoi prej balte, Havaja është e shoqja e Ademit, e krijoi Zoti nga brinja e majtë e Ademit, nga këto të dy ka buruar gjeneracioni i racës njerëzore.*

Nëna është e çmuar në esencë, por atësia quhet më e preferuar mbasi është thelbi i kësaj esence.

*Sqarim: Atësia është më e preferuar sepse: Perfeksionimin dhe cilësitë e larta i trashëgon prej babës, porse nga ana tjetër fëmijët fiziki*





sht kanë më tepër prirje (ngjasim) nga nëna. Një fjalë e urtë thotë: “Burri është më i dobishëm se gruaja për shkak se gjeneracioni buron nga atësia”.

Njerëzia s’kanë përse t’i mburren njëri-tjetrit sepse që të gjithë janë gatuar prej ujit e baltës.

*Sqarim:* Si dihet, njeriu është formuar prej katër elementëve, por në fazën e sipërme është përmendur ujë e baltë, meqë ato formojnë pjesën më të rëndësishme në trupin e njeriut, ndaj dy elementëve të tjerë: zjarri dhe ajri.

Nëqoftëse ti mburrësh për fisnikëri, fisnikëria është bujaria dhe shpirt-lartësia.

Mburrja dhe nderimi u takon vetëm të diturve që udhëheqin njerezinë në udhën e vërtetë.

*Sqarim:* Në mbështetje të fjalës së sipërme është dhe fjala e Profetit tonë që ka thënë: “Dijetarët janë trashëgimtarët e Profetëve”.

*Dituria është vlera dhe mbajtja rind e njeriut, dhe injorantët janë armiq të njerëzve të ditur.*

*Sqarim:* Sado që është thënë se injorantët

janë armiq të dijetarëve, por nuk mund të thuhet se të dy palët janë armiq të njëri-tjetrit, mbasi urtësia e njeriut të ditur nuk pranon armiqësi. Dhe kjo i shëmbëllen veprës së një mjeku që derdh energjinë e tij për të shëruar të sëmurin, duke i dhënë disa barëra që mund të jenë shumë të hidhur, të cilat nuk i pëlqejnë të sëmurit, ashtu sikundër që nuk i pëlqejnë injorantëve, predikimet dhe këshillat e dijetarëve.

Mbaje diturinë dhe mos e shkëmbe me gjë tjetër, se njerëzit vdesin, por dijetarët janë të pavdekshëm. Mos u shoqëro me injorantët, largoje veten prej tyre dhe ata prej teje. Shumë të ditur kanë rënë nga vlera duke u shoqëruar me ta.

*Sqarim:* Dihet se armiku i Zotit është injoranti që nuk i ka përmirësuar sjelljet e tija sipas udhëzimeve fetare dhe nuk i njeh konditat kryesore të fesë. Dhe njeriu i ditur pikërisht këtu ndahet me injorantin.

Njeriu me njerinë njihet kur shoqërohet me të, edhe sendet dallohen kur barazohen me njëri-tjetrin, ashtu dhe zemra me zemrën pajtohen kur kanë një afrim në mes tyre.

*Sqarim:* Në lidhje me fjalën e sipërme të zemrës, është fjala e urtë që thotë: “Në mes të zemrës, në zemër ka një udhë të hapur e të bashkuar që i përshkon”.

U ndryshua dashuria dhe vëllazërimi; u pakësua e drejta dhe u pre shpresa.

*Sqarim:* Imami duke i përdorur këto fjalë është inspiruar nga humbja e besimit që kishte në një jesh të miqve të sinqertë; pora i përket këputjes së shpresës së Imamit, kjo është provokuar nga ai që nuk ka parë ndonjë shenjë përmirësimi ndër miqtë e tij dhe ndarje-prirje të tyre ndaj Zotit.

Koha më dorëzoi tek një shok shumë dredharak e të pa qëndruar dhe që nuk respekton besën e dhënë. Do të mos më bëjnë nevojtar për të, ai që s’e la atë të jetë nevojtar për mua, as vobegësia, as pasuria nuk janë të qëndrueshme.

Sikundër që të mirat e kësaj jete nuk janë të qëndrueshme, ashtu edhe të këqijat e saja nuk kanë qëndrim. Çdo dashuri që bëhet për Zotin është e kulluar, por dashuria e pasuesve është e pakulluar.

*Sqarim:* Me këto fjalë, Hazreti Imami ka patur për qëllim se çdo dashuri e sinqertë që i dedikohet Zotit, përfundon me lumturi e shpëtim në të dy jetët; por ajo dashuri që i bëhet për interes e për të shfryer pasionet

e kësaj jete përfundon në shkatërrim moral e material për autorin.

Sikurse thotë Mexhnuni në vjershën që i drejton të dashurës së tij “Lejlasë”: puthjet që i bëj mureve të shtëpisë sate e të fisit tënd nuk janë nga dashuria që kam për ta, porse ti banon në brendësinë e tyre.

*Shënim:* Puthjet që u bëhen librave të shenjtë, gurit të zi të Qabesë, shtyllave të shtëpisë hyjnore, pëqinjve të udhë-rrëfënjësve dhe duarve të dijetarëve dhe të parëve, varreve të njerëzve të mirë, të gjitha këto bëhen dhe nënkuptimi i tyre tregon bindësinë e përluljes kundrejt Zotit. Dhe kjo përlulsi përfundon në lumturi. Pra duhet të dihet se përluljet dhe respektit që iu bëhen njerëzve të mirë, indirekt i bëhen Zotit, siç thotë fjala e Profetit tonë: “Zemra e besimtarit është thesari dhe shtëpia e Zotit”.

Ndërgjegjia më ndalon, më qorton dhe më turpëron; më tërheq besën dhe fjalën e dhënë një miku të sinqertë. Çdo plagë ka shërim, por imoraliteti nuk ka shërim.

*Sqarim:* Çdo e metë dhe sëmundje që prek njeriun, i gjendet shërimi, por nuk ka ilaç për të zhdukur njollën e njeriut imoral. Në lidhje me këtë, ka thënë prapë Hazreti Muhamed: “Përmirësoni sjelljet tuaja dhe pajisuni me virtytet e Zotit”.

Sa shokëve në kohën e besës u qëndrova besnikë, por prej tyre nuk pashë ndonjë vepër besnikërije.

Shumë njerëz më tregojnë dashurinë kur më shohin, dhe kjo dashuri mbetet sa jemi në takim e kur ndahemi, humbet menjëherë. Disa më tregohen të dashur dhe të afërt, kur unë nuk ua kam nevojën; në kohën e ngushtë më bëhen armiq. Kur unë largohem padashje prej ndonjë njeriu, më dënon me dënimin më të rëndë shembullor.

Me kalimin nga kjo jetë të Kryetarit të Ehli-Bejtit, u shfaqën dashamirësit dhe armiqtë.

*Sqarim:* Fjala Ehli-Bejt ka kuptimin e familjes së Profetit tonë Hazreti Muhamed, kryetari i së cilës ka qenë vetë, dhe pjesëtarët e kësaj familje janë: Hazreti Aliu, Fatimeja, Imam Hasani, Imam Hyzejni dhe të pas lindurit e tyre. Për këtë familje ka zbritur verseti i librit të Shenjtë, Kuranit që thotë: “O ju pjesëtarët e Ehli-Bejtit!

Zoti u ka pastruar rrënjësisht nga çdo ves i keq”.







**// The world bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, conversing to pilgrims in Ballenj - Martanesh**

# The miracle that God made

Bismilahi Rrahmani Rrahim!

In the name of God, Merciful, Mercimaker!

Honored my brothers, Bektashi clergymen and believers!

Honored representatives of the local power, friends and guests!

We are passing difficult times, brought by this world pandemy and the first wish I express you today is: "May you have good health and life in your families! Let High God reward the love you show to the tekkes and do not forget the precious instructions that our honored doctors gives us".

Sisters and brothers,

This miracle that God made in this place, was certainly His will. But were the numerous generations of clergymen and believers of Haxhi Bektash Veli who protected and preserved, graceful and intact, the Bektashi tekke, the sacred place keeping the name of Ballëm Sulttan. With their spirit and their efforts, they further enriched this blessed place.

During the centuries, the natural beauties of these mountains


and valleys are joined by the human and divine beauties.

Ascending to the sacred place of Ballëm Sulttan, certainly we think about all those Bektashi tekkes and sacred places, which gave to this saint the exact image of this tarikat (brotherhood), making him ascend over the superficial mysticism of that time. Foreboding the importance of the Bektashi tarikat at the level of further religious and human developments, especially in Balkan areas, Ballëm Sulttan put on solid bases especially the moral and the ethic of the followers of Imam Ali, demanding from every dervish and baba to be, first of all, a wise and learned man, belonging to the best traditions of the faith. Allow me to bring here today four monumental verses of this saint, who speaks to all the generations of all the times:

To all the believers when they are united  
When the hand of Hynqar they have shaken  
They left the bad works

And if you love Ali, don't touch my wound

And I believe that all of us we know that  
in the Bektashi concept of the union,  
we are one, all of us, a fusion  
in our devotion to the  
Creator, fraternized to  
the level that every





# in this place, was His will

goodness in the family of our brother makes us happy, as well as every sadness in the family of our brother makes us sad. We have been and we will remain always brothers, belly (biological) brothers or Hak ones.

The messages brought in these regions by the life and the work of Ballëm Sulltan have been always resonant, in the time and in the space. The clergymen, but also the myhibs and the followers of the tekkes of Martanesh, Bulqizë and Dibër supported since the beginning the Albanian National Movement, according to the Bektashi principle that we have to defend the Fatherland come by all means, as an obligation towards God. Numerous sources of our historiography verified incontestably that the role of the Bektashi clergymen has been always indisputable in every major movement concerning the diffusion of the Albanian language and concerning the organization of the fighting units for the liberty of Albania. Nowadays this role is always present, linked to the destinies of Albania, testifying not only the love for the nation, but also the endless sacrifices for keeping alive our national spirit.

This role is played also by our brother and your brother, Baba (Father) Hysni Shehu, who followed the best traditions of the clergymen of these tekkes, though in very difficult conditions. I have the pleasure to thank him today for his work

“

**The messages brought in these regions by the life and the work of Ballëm Sulltan have been always resonant, in the time and in the space. The clergymen, but also the myhibs and the followers of the tekkes of Martanesh, Bulqizë and Dibër supported since the beginning the Albanian National Movement, according to the Bektashi principle that we have to defend the Fatherland come by all means, as an obligation towards God. Numerous sources of our historiography verified incontestably that the role of the Bektashi clergymen has been always indisputable in every major movement concerning the diffusion of the Albanian language and concerning the organization of the fighting units for the liberty of Albania. Nowadays this role is always present, linked to the destinies of Albania, testifying not only the love for the nation, but also the endless sacrifices for keeping alive our national spirit.**

”

and for his devotion towards our tarikat.

Also, I express here, today, my deep respect to the Council of the Tekke of Martanesh, to its myhibs and followers, who keep alive our precious traditions, even in difficult times.

*Let God bless all of you!*

*Amen!*

